



PLANI STRATEGJIK I GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS 2021-2025

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
FJALA E KRYETARES	7
1. HYRJE	9
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10
3 METODOLOGJIA	11
4 VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	13
4.1 Vizioni.....	13
4.2 Misioni	13
4.3 Vlerat	14
5 PËRMBLEDHJE E ANALİZËS SË ÇËSHTJEVE KRYESORE	15
5.1 Korniza ligjore për Gjykatën Kushtetuese.....	15
5.2 Njësia Ligjore	16
5.3 Burimet Njerëzore dhe Infrastruktura.....	18
5.4 Financat Publike dhe Transparenca	20
5.5 Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Jashtë	21
5.6 Analiza SWOT	23
6 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	24
6.1 Përmirësimi i Kornizës Ligjore	24
6.3 Burimet Njerëzore dhe Struktura Organizative	30
6.4 Menaxhimi i Financave dhe Shërbimet Mbështetëse	33
6.5 Komunikimi me publikun/mediat dhe Marrëdhëniet me jashtë.....	36
7 MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË	40
7.1 Monitorimi dhe raportimi i strategjisë.....	40
7.2 Vlerësimi i Strategjisë	40
8 NDIKIMI FINANCIAR I STRATEGJISË	41
9 PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	43
Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve në procesin e hartimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, 2021-2025	73

LISTA E SHKURTESAVE

ABEK	Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
DABNJ	Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore
DBF	Departamenti i Buxhetit dhe Financave
DPP	Departamenti për Përkrahje Profesionale
DRLSA	Departamenti për Regjistrimin e Lëndëve, Statistika dhe Arkiv
GIZ	Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJKK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
IRZ	Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar - The German Foundation for International Legal Cooperation
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitetë
LPP	Ligji për Prokurim Publik
LQDP	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJL	Njësia Ligjore
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave Publike
TI	Teknologji Informative
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Bashkëpunim Ndërkombëtar - U.S. Agency for International Development
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS
PLANI STRATEGJIK I GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS
2021-2025

Autorë:

Ruzhdi Halili, ekspert i angazhuar nga Këshilli i Evropës;
Qerkin Berisha, ekspert i angazhuar nga Këshilli i Evropës.

Kontribuues:

Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese
Anëtarët e Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese

Faqosja

Gjykata Kushtetuese e Kosovës

E drejta e autorit

Gjykata Kushtetuese e Kosovës

“Plani Strategjik i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, 2021-2025” është zhvilluar me mbështetjen e Këshillit të Evropës.

FJALA E KRYETARES

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka zbatuar me sukses deri më tanë tri plane strategjike, nëpërmjet të cilave ajo i është nënshtruar ndryshimeve funksionale, strukturore dhe organizative që nga themelimi i saj.

Për dallim nga tri planet e kaluara, Plani i ri strategjik i Gjykatës është hartuar për një periudhë 5-vjeçare (2021 – 2025), nëpërmjet të cilit Gjykata synon të vazhdojë traditën e përballimit të sfidave të së ardhmes, duke u bazuar në përvojën e fituar ndërvite dhe në mundësitet e reja teknologjike.

Çdo fushë, qëllim, objektiv dhe aktivitet është përgjedhur me kujdes të veçantë dhe gjithmonë duke pas parasysh shkallën e zbatimit dhe ngecjet e identikuara në planet e kaluara.

Rritja e cilësisë së vendimeve dhe e procesit të vendimmarjes, konsolidimi i kornizës së brendshme rregullative, zhvillimi i mëtejshmë i kapaciteteve të stafit profesional, përmirësimi i menaxhimit të buxhetit, avancimi i komunikimit me publikun dhe i marrëdhënieve me jashtë, janë ndër pikat kryesore të qëllimeve strategjike të identikuara nga Gjykata si me prioritet për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Plani i ri strategjik është hartuar në kushte dhe në rrethana jo të zakonshme pune, si pasojë e pandemisë COVID-19, që ndryshoi mënyrën e funksionimit dhe të punuarit edhe në Gjykatën Kushtetuese.

Mësimet e nxjerra nga puna e zhvilluar në këto rrethana, vetëm sa na kanë bërë edhe më vigjilent ndaj vizionit dhe misionit tonë, duke qenë gjithmonë në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive elementare të qytetarëve, dhe në mbrojtje të respektimit të kushtetutshmërisë në vend.

Gjykata mbetet e përkushtuar në përbushjen e çdo qëllimi dhe objektivi strategjik të synuar në planin e ri, me qëllimin që nëpërmjet avancimit të kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore, të sigurojë qasje më të lehtë dhe më cilësore të qytetarëve në drejtësinë kushtetuese, si dhe transparencë e llogaridhënie të rritur ndaj publikut.

Implementimi i qëllimeve strategjike të planit pesëvjeçar, i cili është mjaft dinamik dhe gjithëpërfshirës, do të vlerësohet dhe monitorohet në baza periodike nga Gjykata.

Për ndihmën e ofruar në hartimin e Planit Strategjik (2021 – 2025), por edhe për projektet e tjera të realizuara deri më tash, shfrytëzoj rastin që në emër të Gjykatës Kushtetuese të falënderoj përzemërsisht Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Një falënderim të veçantë për kontributin e dhënë në kushte të jashtëzakonshme pune, për identifikimin e prioriteteve strategjike dhe idetë për zhvillimin e Gjykatës drejt së ardhmes, dëshiroj të shpreh edhe për të gjithë gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Arta Rama - Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

1. HYRJE

Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë i cili bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Në këtë kontekst, sipas Kushtetutës ajo është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutë. Vendimet e saj janë të detyrueshme për të gjithë personat, gjykatat dhe institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe nuk mund t'i nënshtrohen rishikimit nga ndonjë mekanizëm tjetër shtetëror.

Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese vepron si gardian përfundimtar i Kushtetutës duke siguruar funksionalitetin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën, bazuar në juridikcionin e saj, si dhe duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive individuale të parapara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ndërkombëtare që janë drejtpërdrejt të aplikueshme në rendin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës. Me mandatin që i është dhënë me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese i jep kuptimin përfundimtar dispozitave kushtetuese pas shqyrtimit të kërkesave që dorëzohen tek ajo nga palët e autorizuara.

Roli dhe përgjegjësitë e Gjykatës Kushtetuese janë të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj për Gjykatën Kushtetuese si dhe Rregulloren e punës. Këto tri dokumente mishërojnë parimet e pavarësisë së Gjykatës në punën dhe misionin e saj si autoritet përfundimtar për interpretim dhe mbrojtje të Kushtetutës. Sigurimi i pavarësisë dhe profesionalizmit të vendimmarrjes së Gjykatës janë segmentet më të rëndësishme të funksionimit dhe përmbushjes me sukses të mandatit të saj.

Prandaj, një vizion dhe planifikim i mirëfilltë strategjik, tejkalimi i sfidave eventuale, ekzistimi i kornizës ligjore adekuate, strukturës dhe sistemit të brendshëm të organizuar dhe funksional, mundësojnë që ky mandat i Gjykatës Kushtetuese të realizohet në praktikë. Përmes përgatitjes së Strategjisë afatmesme 2021-2025, mbi bazën e të cilës janë përcaktuar objektivat strategjike dhe aktivitetet në funksion të avancimit të punës së saj, Gjykata Kushtetuese vodos në pah pavarësinë, paanësinë, integritetin, kualitetin e vendimmarrjes dhe profesionalizmin – si parakushte për besueshmërinë dhe ndikimin e saj në realizimin e mandatit të saj kushtetues.

Gjykata ka një përvojë të mirë në planifikim strategjik për zhvillim organizativ dhe profesional që nga formimi i saj. Bazuar në kornizën e planifikimit dhe objektivat e deritashme, është bërë vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për vitet 2018-2020, nga i cili konstatohen arritje në përmbushjen e plotë të shumicës dërrmuese të objektivave të përcaktuara. Përmes zbatimit të objektivave strategjike, Gjykata ka rritur efikasitetin e saj në zgjidhjen e rasteve, ka avancuar kualitetin e vendimmarrjes, ka ngritur në vazhdimësi kapacitetet profesionale të personelit të Gjykatës në funksion të përmbushjes së mandatit të saj dhe ka ruajtur pavarësinë e saj operacionale dhe financiare. Megjithatë, dinamika e ndryshimeve dhe zhvillimeve ligjore, shoqërore e teknologjike në vazhdimësi paraqet nevojën për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve përmes adresimit adekuat të çështjeve të reja si dhe avancimit të mëtejmë në të gjitha fushat e mbuluara me këtë Strategji.

Strategja e Gjykatës për periudhën e ardhshme afatmesme synon të fokusohet në pesë fusha kryesore: 1) Avancimi i kornizës ligjore; 2) Cilësia dhe efikasiteti i vendimeve të Gjykatës; 3) Burimet njerëzore dhe struktura organizative; 4) Menaxhimi i financave dhe shërbimet mbështetëse dhe; 5) Komunikimi, marrëdhëniet më publikun dhe bashkëpunimi me jashtë. Në secilën prej këtyre fushave janë përcaktuar qëllimet strategjike dhe objektivat specifike në funksion të arritjes së qëllimeve të kësaj Strategjie. Në kuadër të këtyre fushave të Strategjisë është bërë një shqyrtim objektiv i nevojave aktuale, duke mundësuar që të përcaktohen objektivat afatmesme dhe duke parashikuar veprime të matshme që synojnë arritjen e këtyre objektivave.

Zbatimi i kësaj Strategjie dhe masave të planifikuara përmes planit për zbatimin e saj, varet para se gjithash nga një vullnet dhe angazhim i drejtpërdrejtë i menaxhmentit të Gjykatës. Ky vullnet padyshim është dëshmuar në vazhdimësi duke shprehur qartë vizionin që synohet dhe përkushtimin në zbatimin e masave të planifikuara për të arritur këtë vizion. Përveç kësaj, përfshirja, përkrahja dhe angazhimi i gjithë stafit të Gjykatës si bartës kryesor i zbatimit janë faktor po aq i rëndësishëm drejt realizimit të vizionit të kësaj Strategjie.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Gjykatës Kushtetuese për vitet 2021-2025 përfshin qëllimet strategjike dhe objektivat specifike të cilat do të arrihen përmes planit trevjeçar të veprimit, i cili paraqitet si pjesë integrale e Strategjisë. Progresi i arritjes së objektivave do të matet përmes treguesve dhe caqeve të cilat janë të vendosur krahas objektivave specifike.

Strategja përbëhet nga pjesa hyrëse, përbledhja ekzekutive, metodologja e punës për hartimin e saj, një përbledhje e situatës aktuale që derivon nga raporti për vlerësimin e zbatimit të strategjisë 2018-2020 si dhe SWOT analiza.

Pjesa kryesore e Strategjisë përbëhet nga kapitulli i cili përmban qëllimet strategjike, objektivat specifike, treguesit dhe caqet të organizuara sipas fushave kryesore në të cilat Gjykata synon të përqendrojë aktivitetet kryesore gjatë periudhës së ardhshme pesë vjeçare. Në kuadër të kësaj, Strategja përbëhet nga pesë fusha dhe qëllime strategjike si dhe objektivat specifike si më poshtë e të mbështetura nga pjesa tekstuale strategjike.

Qëllimi Strategjik 1: Avancimi i cilësisë dhe zbatimit të kornizës ligjore

Objektivat Specifike:

- 1.1.** Avancimi i kapaciteteve të Gjykatës për të ndikuar në procesin legjislativ që ndikon në funksionimin dhe pavarësinë e Gjykatës;
- 1.2.** Plotësimi, harmonizimi dhe konsolidimi i kornizës së brendshme rregullative;
- 1.3.** Avancimi i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin efektiv të rregullativës së brendshme të Gjykatës.

Qëllimi Strategjik 2: Rritja e cilësisë së vendimeve dhe efikasitetit të vendimmarrjes së Gjykatës

Objektivat Specifike:

- 2.1.** Rritja e vazdueshme e cilësisë së vendimeve të Gjykatës duke siguruar konsistencë të praktikës së brendshme dhe duke përmirësuar referencën në praktikën gjyqësore ndërkombëtare;
- 2.2.** Forcimi i kapaciteteve të Njësisë Ligjore, me theks të veçantë në fushën e hulumtimit profesional;
- 2.3.** Avancimi i sistemit të menaxhimit të rasteve përmes koordinimit, thjeshtësimit administrativ të procedurave si dhe avancimit të mëtejmë të CDMS-së.

Qëllimi Strategjik 3: Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve njerëzore dhe strukturës organizative të Gjykatës

Objektivat Specifike:

- 3.1.** Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve të stafit profesional dhe shërbimeve të mbështetjes së Gjykatës përmes planifikimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit;
- 3.2.** Konsolidimi i një praktike të mirë në lidhje me komunikimin e brendshëm;
- 3.3.** Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit të Gjykatës përmes programeve të shkëmbimit;
- 3.4.** Përmirësimi i mëtejmë i strukturës organizative të Gjykatës.

Qëllimi Strategjik 4: Avancimi i menaxhimit të buxhetit dhe burimeve të tjera financiare dhe shërbimeve mbështetëse në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës

Objektivat Specifike:

- 4.1.** Sigurimi i planifikimit të duhur të buxhetit të Gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të saj;
- 4.2.** Sigurimi i një procesi efikas dhe efektiv të zbatimit të shpenzimeve së bashku me një program të rregullt monitorimi në baza tremujore;
- 4.3.** Rritja e cilësisë së reagimit ndaj auditimit të jashtëm dhe mbajtja e një procesi transparent të kontrollit të brendshëm financiar;

- 4.4.** Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes së nevojshme për Gjykatën në funksion të realizimit të objektivave të saj;
- 4.5.** Mirëmbajtja dhe avancimi i infrastrukturës së TI-së sipas nevojave të Gjykatës dhe në përputhje me zhvillimet në rritje të TIK-ut.

Qëllimi Strategjik 5: Avancimi i komunikimit me publikun/mediat dhe marrëdhënieve me jashtë

Objektivat Specifike:

- 5.1.** Përmirësimi i komunikimit brenda Gjykatës;
- 5.2.** Informim më i mirë i opinionit publik për punën dhe aktivitetet e Gjykatës;
- 5.3.** Komunikim më i mirë me mediat dhe shoqërinë civile;
- 5.4.** Rritja e bashkëpunimit me gjykatat e rregullta dhe komunitetin juridik;
- 5.5.** Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Gjykatës.

Një kapitull i veçantë i strategjisë përcakton sistemin e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të saj. Sistemi i monitorimit siç përshkruhet më poshtë përbëhet nga mekanizmat institucionalë të monitorimit dhe proceset e raportimit dhe vlerësimit.

Gjithashtu, Strategjia përmban një kapitull i cili prezanton informata të përbledhura të kostos financiare për zbatimin e saj në nivel të secilit aktivitet të përfshirë në planin e veprimit për periudhën e ardhshme trevjeçare.

3 METODOLOGJIA

Strategjia e Gjykatës Kushtetuese 2021-2025 është hartuar mbi bazën e një analize të detajuar që ka pasur për qëllim të vlerësojë zbatimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2018-2020. Ky vlerësim ka marrë përbazë sukseset e arritura, sfidat dhe zhvillimet e pritshme për periudhën e ardhshme për Gjykatën Kushtetuese. Praktikat më të mira vendore, rajonale dhe ndërkombëtare¹ në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike janë marrë përbazë gjatë hartimit të strategjisë.

Procesi i hartimit të Strategjisë është udhëhequr nën mbikëqyrjen e udhëheqjes së Gjykatës Kushtetuese dhe se gjatë gjithë procesit të hartimit të Strategjisë janë përfshirë gjyqtarët, të gjithë anëtarët e Njësisë Ligjore si dhe personeli i Sekretariatit të Gjykatës. Personeli i Gjykatës Kushtetuese ka marrë pjesë në mënyrë aktive në tryezat e organizuara për diskutim, në intervistat e drejtpërdrejta të strukturuara, dhe përmes dorëzimit të dokumenteve, komenteve dhe sugjerimeve të vazhdueshme. Në hartimin e Strategjisë kanë ndihmuar ekspertët e angazhuar nga Këshilli i Evropës, z. Ruzhdi Halili dhe z. Qerkin Berisha.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka përfshirë disa faza:

Faza përgatitore dhe planifikimi i hartimit të Strategjisë (përfshirë takimet fillestare me personelin e Gjykatës Kushtetues dhe intervistat) - Gjatë muajit shtator 2020, ekspertët kanë zhvilluar takime me personelin e Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë gjyqtarët, udhëheqësit e departamenteve dhe Njësisë Ligjore në Gjykatë. Në këtë fazë janë takuar udhëheqësit e grupeve përgjegjëse për secilin objektiv të Strategjisë 2018-2020. Gjatë kësaj faze janë mbledhur informacione të përgjithshme për situatën aktuale, sfidat dhe çdo informacion tjetër i rëndësishëm për procesin e hartimit të Strategjisë së re.

¹ OECD (OBZHE), *Manual për përgatitjen, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e reformës së administratës publike dhe strategjitë sektoriale, Udhëzues për partnerët e SIGMA-së*, Dokument Nr.57, OECD(OBZHE) Publikimi, Paris, 2028, <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/37e212e6-en.pdf?Expires=1606684331&id=id&accname=guest&checksum=D2071265DCA319C64B8A41660CEAD7D7>

Mbledhja e të dhënave, informacioneve dhe analiza fillestare e situatës (përfsfirë hartimin e Raportit për zbatimit e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për 2018-2020) - Gjatë kësaj faze janë mbledhur dhe analizuar të dhënat dhe informacionet e nevojshme për të bërë analizën e situatës, duke përfshirë raportet e brendshme të Gjykatës. *Raporti për zbatimit e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për 2018-2020* është përgatitur si një vlerësim që identifikon arrijet dhe sfidat në zbatimin e Planit Strategjik dhe shërben si pikënisje për zhvillimin e Strategjisë së re të Gjykatës. Vlerësimi kishte për qëllim po ashtu të mundësojë zhvillimin e objektivave strategjike dhe specifike për Strategjinë 2021-2025, duke mundësuar vendosjen e prioriteteve për Gjykatën në periudhën e ardhshme pesëvjeçare. Gjatë kësaj faze janë mbledhur dhe analizuar edhe vlerësimet nga institucione dhe mekanizma ndërkombëtarë për aspekte të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese.

Diskutime në tryeza pune me Gjykatën Kushtetuese (përgatitja e Analizës SWOT; përcaktimi i objektivave strategjike dhe specifike të Strategjisë) - Më 1 dhe 2 tetor 2020, janë zhvilluar takime pune me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe personelit të Gjykatës Kushtetuese, ku janë prezantuar gjetjet e Raportit për zbatimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese 2018-2020, të cilat gjetje janë konfirmuar nga këto takime. Takimet kanë shërbyer po ashtu edhe për zhvillimin e analizës SWOT dhe në të njëjtën kohë për përcaktimin e objektivave strategjike. Më datën 3 nëntor 2020, është zhvilluar takimi i radhës me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe personelit të Gjykatës Kushtetuese, ku janë vendosur objektivat strategjike dhe ato specifike të Strategjisë 2021-2025.

Hartimi i Strategjisë – Gjatë kësaj faze, është përgatitur drafti i Strategjisë, i cili ka marrë përbazë gjetjet nga Raporti i zbatimit të strategjisë paraprake, SWOT analiza, diskutimet e zhvilluara me gjyqtarë dhe personelin tjetër të Gjykatës. Drafti i Strategjisë, i cili përfshinte fushat, qëllimet strategjike, objektivat specifike dhe indikatorët/treguesit është përcjellë tek personeli i Gjykatës Kushtetuese për komente dhe finalizim. Secili nga grupet e themeluara sipas objektivave, pas takimeve të mbajtura, kanë dhënë kontributin e tyre në finalizimin e objektivave specifike. Në të njëjtën kohë janë përgatitur dhe përcjellë tek kryesuesit e gupeve edhe kërkessat për informacionin që do të përfshijë Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë, i ndarë sipas objektivave specifike.

Hartimi i Planit të Veprimit duke përfshirë koston e zbatimit të strategjisë – Procesi i përgatitjes së planit të veprimit të strategjisë, duke përfshirë kostimin ka filluar në të njëjtën kohë me përgatitjen e draftit të Strategjisë, në momentin kur janë përcaktuari objektivat strategjike dhe specifike. Puna në hartimin e aktivitetave të planit është udhëhequr nga grupet punuese, nën këshillimin e ekspertëve të angazhuar.

4 VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

4.1 Vizioni

Republika e Kosovës është një shtet demokratik, që udhëhiqet nga vlerat kushtetuese të lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese luan rolin e saj të përcaktuar nga vet Kushtetuta - si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. E udhëhequr nga Kushtetuta dhe vlerat e parimet e proklamuara aty, Gjykata luan rol themelor në garantimin përfundimtar të kushtetutshmërisë në vend, me fokus të veçantë në mbrojtjen e garancive kushtetuese dhe atyre që ndërlidhen me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

4.2 Misioni

Gjykata Kushtetuese si mision të saj ka përfundimin me sukses të të gjitha detyrave të saj publike të përcaktuara me Kushtetutë. Në kryerje të këtij misioni, Gjykata merr për bazë vlerat dhe parimet mbi të cilat është parashikuar të funksionojë Republika e Kosovës, si një shtet i ri demokratik që mbron dhe garanton kushtetutshmërinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatë Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Gjykata Kushtetuese si institucion kompetent për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, nuk vepron *ex officio* - por është konceptuar si organ publik që garanton kushtetutshmërinë dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga palët e autorizuara. Gjykata Kushtetuese është e përkushtuar për të kontribuar në arrijen e këtij vizioni kushtetues duke punuar me përkushtim që të jetë një organ publik i përgjegjshëm dhe transparent që siguron se shërbimet për shtetin dhe qytetarët e tij do të ofrohen nga:

- një institucion profesional dhe i pavarur, që krijon dhe kultivon një kulturë shembullore të bashkëpunimit ndër-institucional, duke ruajtur dhe mbrojtur elementet e nevojshme të pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore;
- një institucion me standarde të larta të funksionimit dhe të kualitetit vendimmarrës, që garanton llogaridhënie dhe transparencë drejt kryerjes së detyrave publike të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, përfshirë komuniteteve jo-shumicë;
- një institucion i cili në fokus ka interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe kryerjen me përgjegjësi të secilës detyrë juridikionale të paraparë me Kushtetutë dhe Ligj.

4.3 Vlerat

Gjykata Kushtetuese në kontekst të sigurimin të llogaridhënisë dhe përgjegjësisë për respektimin e Kushtetutës, si dhe për të nxitur besimin e publikut në drejtësinë kushtetuese dhe sundimin e ligjit, do të mbështesë vlerat e mëposhtme:

- **Respektimi dhe mbrojtja e Kushtetutës** – Gjykata Kushtetuese si interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës, konsiderohet si “gardian i Kushtetutës”;
- **Ndershmëria dhe Integriteti** – veprimet e gjyqtarëve në harmoni me standarde më të larta profesionale dhe morale, për ruajtjen dhe avancimin e drejtësisë kushtetuese si dhe ruajtjen e reputacionit të Gjykatës Kushtetuese;
- **Drejtësia dhe paanësia** – Gjykata Kushtetuese gjykon bazuar vetëm në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, duke siguruar një trajtim të drejtë dhe të paanshëm për të gjithë pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenën, mendimet politike ose të tjera, prejardhjen kombëtare a shoqërore, lidhjen me ndonjë komunitet, pronën, gjendjen ekonomike, sociale, orientimin seksual, lindjen, aftësinë e kufizuar ose ndonjë status tjetër personal;
- **Transparenca** – Gjykata Kushtetuese udhëhiqet nga parimet e përgjegjshmërisë, transparencës dhe hapjes në komunikim me parashtruesit e kërkesave në veçanti dhe publikun në përgjithësi, duke njoftuar për vendimet e marra si dhe duke mundësuar që të njëjtat të janë të qasshme në mënyrë të lehtë nga palët e interesuara, studentët, komuniteti akademik dhe publiku në përgjithësi;
- **Siguria juridike** – Gjykata Kushtetuese do të garantojë parimin e sigurisë juridike, i cili është esencial për besimin në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe gjyqësisë kushtetuese në veçanti;
- **Sundimi i ligjit** - Gjykata Kushtetuese në punën e saj vepron në përputhje me vlerat e kushtetutshmërisë, sigurissë juridike, ndalimit të veprimit në mënyrë arbitrale, barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, qasjes në drejtësi, gjykimit të drejtë dhe drejtësisë kushtetuese, të cilat kanë për qëllim të garantojnë respektimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës;
- **Efikasiteti** - Gjykata siguron trajtim efektiv të kërkesave të dorëzuara para saj si dhe kualitet të vendimeve në përputhje me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren e punës, përmes planifikimit strategjik dhe përdorimit më të mirë të burimeve në dispozicion.

5 PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SË ÇËSHTJEVE KRYESORE

5.1 Korniza ligjore për Gjykatën Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese luan një rol vendimtar në ndërtimin dhe avancimin e konceptit të shtetit të së drejtës në njëren anë, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në anën tjetër. Prandaj, me qëllim të sigurimit të funksionimit dhe avancimit të këtij roli në të ardhmen, është më se e rëndësishme të vihet theksi tek pavarësia gjyqësore që është parakusht për sundimin e ligjit dhe një garanci themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese siç definohet në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, është një faktor qenësor dhe jashtëzakonisht i rëndësishëm për funksionimin e Gjykatës. Prandaj, ruajta dhe avancimi i mekanizmave që sigurojnë pavarësinë e saj, përvèç tjerash edhe nga legjislacioni i ri, është domosdoshmëri e përhershme.

Për të arritur këtë qëllim, Gjykata ka krijuar mekanizma përmes të cilëve ajo mund të jap kontributin e vet ose të intervenojë në fazën e procesit të hartimit të legjislacionit nga ana e institucioneve bartëse të hartimit dhe miratimit të legjislacionit. Si rezultat i kësaj, në mënyrë proaktive është identifikuar dhe analizuar legjislacioni që ka mundur potencialisht të ndikojë në funksionin dhe pavarësinë e Gjykatës, dhe janë dhënë komente në cilësi të palës së interesuar qysh në fazën e hartimit të iniciativave të tilla ligjore.

Përgjatë dhjetë viteve të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të sigurimit të funksionimit të brendshëm, pavarësisë dhe integritetit të saj, Gjykata ka punuar në rritjen e cilësisë së kornizës ligjore përmes përgatitjes së Udhëzimit mbi procedurat për hartimin, ndryshimin dhe miratimin e akteve të brendshme ligjore. Gjykata tashmë ka 21 akte të brendshme (shih tabela 1). Me ndihmën e USAID është bërë vlerësimi për të identifikuar mospërputhjet e mundshme brenda akteve të brendshme apo me aktet më të larta ligjore. Raporti ka gjetur disa aspekte të cilat do të adresohen gjatë periudhës së ardhshme të planifikimit. Udhëzimi për procedurat e hartimit, dhe raporti duhet të miratohen nga Gjykata në seancë administrative nga Gjykata. Me miratimin e Udhëzimit, dhe me miratimin e rapportit vlerësues pritet të punohet në harmonizimin dhe thjeshtimin e kornizës ligjore të brendshme.

Viti	Rregullore	Udhëzime Administrative	Udhëzime Praktike	Kode	Gjithsej
2010	0	2	0	0	2
2011	0	0	0	1	1
2012	3	1	0	0	4
2013	3	0	1	0	4
2014	0	0	0	0	0
2015	2	0	0	0	2
2016	1	0	0	0	1
2017	2	0	0	0	2
2018	2	0	0	0	2
2019	1	2	0	0	3
Total	14	5	1	1	21

Tabela 1: Aktet e brendshme normative në fuqi, sipas vitit të miratimit (burimi: Raporti mbi vlerësimin e Kornizës Rregullative të Brendshme, dhjetor 2019 - prill 2020)

Rritja e transparencës në punën e Gjykatës përfshirë edhe transparencën në aspektin e hartimit të akteve të brendshme dhe qasjes së plotë, duke përcaktuar se cilat dokumente ligjore janë publike dhe cilat janë për përdorim të brendshëm ishte një nga synimet e vazhdueshme të Gjykatës. Megjithatë ky segment akoma mbetet një nga sfidat në të cilat Gjykata duhet të përqendrohet në të ardhmen e saj. Nga aktet e brendshme të Gjykatës, vihet re se tashmë janë

të publikuara vetëm Rregullorja e Punës; Rregullorja e Njësisë Ligjore, Kodi i Mirësjelljes dhe Udhëzimi mbi praktikat për paraqitjen e parashtresave *Amicus Curiae*. Prandaj, përgjatë zbatimit të objektivave të kësaj Strategjie, Gjykata mbetet të punojë edhe më tej në këtë drejtim.

5.2 Njësia Ligjore

Njësia Ligjore si strukturë e veçantë organizative në Gjykatën Kushtetuese, kryen detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve, duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjeter ligjor në varësi të nevojave të Gjykatës në procesin e trajtimit të rasteve.

Njësia Ligjore si njëra nga shtyllat kryesore profesionale të Gjykatës, është e angazhuar në rritjen e efikasitetit të Gjykatës si dhe mundësimin e realizimit me profesionalizëm të gjykimit kushtetues. Hartimi i *Memo-s* nga Njësia Ligjore, me të cilin vendosen afate të parashikuara të shqyrtimit të një rasti prej 5.3 deri në 6 muaj, vlerësohet si një hap i rëndësishëm në shkurtimin e kohës së përgatitjes së rasteve për vendimmarrje nga ana e gjyqtarëve. Sistemi i shpërndarjes së rasteve për këshilltarët kushtetues juridik është treguar efikas si pasojë e koordinimit të mirë të ngarkesës dhe ndarjes së punës ndërmjet Njësisë Ligjore me njësitë e tjera si DRLSA, DPP, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Departamenti i TI-së. Si instrument për rritjen e efikasitetit dhe kualitetit të vendimmarrjes në Gjykatë, modeli i bashkëpunimit të këshilltarëve me gjyqtarët në përgatitjen e rasteve ku secili këshilltar kushtetues juridik do të bashkëpunojë më secilin nga gjyqtarët është konsideruar në përgjithësi si pozitiv. Megjithatë, është shtruar nevoja e diskutimit rrithë përmirësimit të mëtejshmë të këtij modeli në shërbim të rritjes së efikasitetit dhe kualitetit të vendimmarrjes. Sistemi elektronik CDMS është shumë i rëndësishëm për rritjen e efikasitetit në menaxhimin e rasteve dhe shpërndarjen e informatave. Sfidë e identifikuar edhe nga analiza SWOT paraqitet mungesa e përdorimit të tij nga ana e të gjithë punonjësve në Gjykatë, përveç njësisë së regjistrimit DRLSA.


Gjatë tre viteve të zbatimit të planit të fundit strategjik vërehet trend pozitiv në numrin e zgjidhjes së rasteve krahasuar me rastet e pranuara. Në vitin 2018, 64%; Në vitin 2019, 87%, ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 ishte 81% e rasteve të zgjidhura në raport më numrin e rasteve të pranuara gjatë të njëjtit vit. Megjithatë, numri i rasteve në trajtim mbetet i lartë duke marrë parasysh edhe rastet që barten nga viti paraprak, por edhe rritjen e numrit të rasteve të pranuara dhe rritjes së nivelit të vështirësisë. Mesatarja e shqyrtimit të rasteve për vitin 2019 ishte 10.7 muaj, ndërsa në gjashtëmujorin e vitit 2020 ka rënë në 9.64 muaj (shih tabela nr. 2).

Viti	Kërkesa të pranuara	Kërkesa në punë	Raste të zgjidhura	Realizimi në %	% e kërkesave të zgjidhura kundrejt kërkesave të pranuara	Mesatarja e shqyrtimit
2018	206	299	133	44.5%	64%	N/A
2019	243	410	213	52%	87%	10,7 muaj
2020	195	392	206	52.6%	105.6%	17,4 muaj

Tabela 2: Statistikat e rasteve në GJKK gjatë viteve 2018, 2019, 2020 (burimi: raportet vjetore të Gjykatës)

Një çështje që vlen të theksohet është edhe numri i lartë i vendimeve që rezultojnë si të papranueshme në raport me numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve (shih figura nr. 1). Edhe

pse numri i kërkesave që përfundojnë me aktgjykim viteve të fundit është rritur nga 3% sa ka qenë në vitin 2016, në 9% në vitin 2019, ky numër prapë mund të konsiderohen si shumë i ulët. Megjithatë, duhet pasur parasysh që Gjykata në ndërlidhje me këtë çështje të planifikimit paraprak të Aktgjykimeve, është e kufizuar tërësisht nga natyra e shkeljeve të pretenduara të cilat pranohen si kërkesa në Gjykatë si dhe nga mënyra e argumentimit.



Vlerësohet se në dhjetë vitet e ekzistencës së saj, Gjykata e ka bazuar jurisprudencën e saj në një përdorim të gjerë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Ky trend ka ngjarë si i tillë jo vetëm në vitet e para të veprimtarisë, por edhe në vendimet e saj më të fundit, duke avancuar çdo herë e më shumë referencat e përdorura për raste specifike. Referencia në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së bëhet jo vetëm në lidhje me interpretimin e të drejtave të njeriut të përfshira në KEDNJ, por gjithashtu edhe në lidhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara nga neni 35 i KEDNJ-së dhe çështje të tjera procedurale, përderisa kjo praktikë gjyqësore konsiderohet relevante për të vendosur mbi pranueshmërinë e kërkesave para Gjykatës.² Njësia ligjore dhe Juristkonsulti luajnë rol kyç në përmirësimin e përdorimit të praktikës gjyqësore të brendshme të Gjykatës, praktikës së GJEDNJ-së, praktikave të gjykatave kushtetuese simotra të shteteve të tjera që janë pjesë e Forumit të Komisionit të Venecias, etj. Synimi është që në të ardhmen e afërt, Gjykata t'i referohet edhe praktikës së GJDBE-së.

Përmirësimi i kapaciteteve kërkimore të stafit për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e vendimeve mbetet një çështje për të cilën Gjykata në vazhdimesi duhet të planifikojë dhe veprojë. Në këtë pjesë do duhet të sqarohet edhe mandati i Njësisë Ligjore dhe definimi praktik i rolit të Juristkonsultit. Tashmë Gjykata është anëtarësuar në disa databaza me renome të burimeve elektronike, përfshirë qasjen e vazhdueshme në CODICES të Forumit të Komisionit të Venecias. Vlen të theksohet që përpilimi i Udhëzuesit për unifikimin e citimeve të vendimeve të Gjykatës dhe vendimeve të tjera ndërkombëtare, vlerësohet si iniciativë e duhur. Krahas kësaj, në kontekst të trajnimit të vazhdueshëm të këshilltarëve kushtetues juridikë, vlen të theksohet se janë organizuar disa trajnime specifike për çështje të neneve të caktuara të KEDNJ-së. Gjithashtu, GJKK në bashkëpunim me projektin mbështetës të Këshillit të Evropës, ka organizuar vizita studimore për disa këshilltarë kushtetues juridikë në GJEDNJ. Ky projekt, që përfshinte një komponentë shumë të rëndësishme të trajnuarit të

² Trajkovska, Mirjana Lazarova. (2020). Vlerësimi i implementimit të KEDNJ-së nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Këshilli i Evropës, Raport i Brendshëm.

këshilltarëve në nene specifike të KEDNJ-së, si dhe të trajtuarit në procesin e menaxhimit të rasteve që nga pikë fillestare nga GJEDNJ-ja, konsiderohet si një praktikë shumë e dobishme, e cila pritet të vijojë edhe me këshilltarët e tjerë të Gjykatës. Rrjetohimisht, Projekti i Këshillit të Evropës për dërgimin e këshilltarëve dhe gjyqtarëve në trajnime dhe vizita studimore në GJEDNJ është vlerësuar si shumë i dobishëm dhe rekandohet gjetja e mundësive përvazhdimin e tij. Në anën tjetër, në kontekstin e përmirësimit të shkrimit ligjor janë organizuar punëtori dhe takime me gjyqtarë nga rajoni.

Një nga sfidat me të cilat është ballafaquar GJKK është edhe largimi i disa këshilltarëve; numri i vogël i këshilltarëve krahasuar me numrin e rasteve dhe vështirësisë në rritje të tyre; si dhe planifikimi paraprak në këtë aspekt. Duhet të punohet edhe më tej në zvogëlimin e mesatares së zgjidhjes së rasteve, duke përfshirë edhe vendosjen e afateve të ndryshme për kategori të ndryshme të rasteve. Krahas kësaj, Gjykata duhet të punojë më shumë në vetëdijesimin e shoqërisë përmadatin e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që numri i rasteve të papranueshme të zvogëlohet në të ardhmen. Strategjia e ardhshme duhet të vazhdojë të ketë një fokus të lartë në këto fusha.

5.3 Burimet Njerëzore dhe Infrastruktura

Gjendja e burimeve njerëzore është vlerësuar si pozitive në GJKK. Përshkrimet e vendeve të punës dhe plotësimi i pozitave të vendeve të punës sipas strukturës nuk ka paraqitur ndonjë ngecje. Rreziku i ndërhyrjes në pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, ndër to edhe Gjykatës, që ka paraqitur pakoja e legjisacionit të reformës së administratës publike është shhangur si rezultat i kontestimit të këtyre iniciativave ligjore në Gjykatën Kushtetuese nga ana e palëve të autorizuara. Përmes vendimmarrjes së Gjykatës është parandaluar, në nivel të Republikës, zbatimi i normave të reja ligjore të cilat është konsideruar se do të kishin efekt negativ dhe kundërkushtetues në ndarjen e pushteteve dhe funksionimin e pavarur të gjyqësorit dhe institucioneve të tjera të pavarura.

Gjykata Kushtetuese aktualisht ka 66 të punësuar. Plotësimi i pozitave sipas organogramit të Gjykatës nuk ka paraqitur ndonjë problem. Megjithatë, Gjykata ka edhe 4 pozita shtesë të lira dhe të buxhetuara, të cilat nuk janë plotësuar fillimisht si rezultat i renovimit të objektit të Gjykatës dhe më pas nga situata pandemike me COVID 19. Shpërndarja e stafit sipas organogramit të Gjykatës është si në figurën nr. 2, në vijim:




Figura 2: Struktura organizative dhe shpërndarja e stafit në GJKK (burimi: Struktura Organizative e GJKK-së)

Gjykata Kushtetuese ka të vodosur një sistem për vlerësimin e performancës së punës. Planifikimi i punës bëhet në nivel të organizatës, në nivel të njësive, dhe në nivel individual. Ekziston planifikim i trajnimeve sipas identifikimit të nevojave përmes formularëve të vlerësimit të performancës por edhe sipas ofrimit dhe organizimit të tyre nga donatorët dhe institucionet e tjera (IKAP, Institut Gjyqësor) (shih tabela nr. 3).

Aktivitetet e Gjykatës gjatë viteve 2018, 2019, 2020			
Aktivitetet e Gjykatës gjatë viteve 2018, 2019, 2020	2018	2019	2020
Aktivitet			
Vizita studimore, tryeza, forume dhe shkolla verore jashtë vendit	4	7	2
Punëtori jashtë vendit	6	4	/
Punëtori brenda vendit	1	1	4
Konferencë jashtë vendit	2	1	1
Seminare jashtë vendit	2	0	/
Seminare brenda vendit	1	1	/
Trajnime brenda vendit	7	22	10
Trajnime jashtë vendit	3	0	/
Kurse të gjuhëve të huaja	2	1	/
Uebinar, tryeza online	0	0	7
Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve	161	162	191

Tabela 3: Aktivitetet e Gjykatës gjatë viteve 2018, 2019, 2020 (burimi: raportet vjetore të Gjykatës)

Monitorimi i zbatimit të planit të punës bëhet përmes një raportimi në baza tremujore për secilin departament. Njësia Ligjore ka një linjë të drejtpërdrejtë raportimi te Kryetari/ja i/e Gjykates, dhe rrjedhimisht edhe mënyra e raportimit ndryshon. Çdo anëtarë i Njësisë Ligjore paraqet raport mënyra tek Këshilltari/ja i/e Parë Kushtetues Juridik, i/e cili/a pastaj e njofton Kryetarin/en për mbarëvajtjen e punëve brenda Njësisë Ligjore. Gjykata që nga themelimi i saj ka miratuar Rregulloren e punës e cila është përditësuar ndër vite dhe po ashtu Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Punës së Gjykatës. Rregullorja e punës së Gjykatës themelon

Njësinë Ligjore, ndërsa organizimi i saj që përbëhet nga Këshilltarët kushtetues juridikë bëhet përmes Rregullores së Njësisë Ligjore Nr. 03/2019.³ Në bazë të analizës së strukturës organizative të Gjykatës, nuk vlerësohet e nevojshme të ketë ristrukturim apo ndryshim thelbësor të strukturës organizative të GJKK-së, megjithatë ndryshimet dhe përmirësimet e strukturës, plotësimet e saj, si dhe nevojat për identifikimin dhe vendosjen e pozitave të reja ose pozitave shtesë kërkojnë një qasje analitike të bazuar në analiza dhe shqyrtim të alternativave më të mira të cilat mund t'i shërbejnë arritjes së objektivave të Gjykatës dhe zbatimit të mandatit të saj. Tani për tani, Gjykatës i mungon disponueshmëria e informatave të konsoliduara për burimet njerëzore dhe mungesa e një sistemi të përshtatshëm elektronik për menaxhimin e tyre sipas nevojës së Njësisë për burime njerëzore dhe Gjykatës.

Sa i përket Infrastrukturës, me përfundimin e projektit të mbindërtimit dhe renovimit të objektit ekzistues, Gjykata Kushtetuese rriti hapësirat e saj punuese për afro 525 m². Kjo ka mundësuar akomodim e të gjithë stafit të Gjykatës në kushte komode. Projekti kishte një kosto totale prej 379,410.98 €. Vlerësohet se realizimi i projektit ka arritur qëllimin e tij dhe se ka siguruar kushte të mira pune dhe hapësira të mjaftueshme për sistemimin e të gjithë stafit të Gjykatës.

Gjykata ka avancuar në vazhdimësi edhe me digitalizimin e punës së saj. Krahas kësaj janë mundësuar edhe trajnime dhe avancim i njohive të stafit. Sfidë është paraqitur mungesa e instrumenteve për siguri kibernetike në Gjykatë, shtuar tani edhe faktin se për shkak të pandemisë COVID-19 Gjykata mban seancat në formatin online. Rekomandohet që gjatë periudhës së ardhshme planifikuese, t'i kushtohet vëmendje e duhur sistemit të menaxhimit të rasteve dhe përmirësimi i tij sipas zhvillimeve dhe avancimeve të teknologjisë informative. Kjo duhet të bëhet në linjë me nevojat e reja të Gjykatës marrë parasysh rëndësinë e këtij sistemi në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Gjykatës. Në veçanti rekomandohet përditësimi i sistemit në pajtim me gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit të nevojave të sistemit. Kjo do të përfshinte edhe ofrimin e qasjes në distancë në sistem të menaxhimit të rasteve, përmirësimin e kërkimeve, lidhjen me ueb faqen për të mundësuar po ashtu që palët të mund të marrin informata për statusin e rastit të tyre. Shablonet (templates) dhe *Memoja*, rekomandohet të lidhen me sistemin gjithashtu.

5.4 Financat Publike dhe Transparenca

Gjykata Kushtetuese gjëzon pavarësi financiare në realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë. Kjo pavarësi është përcaktuar edhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese (neni 2.1 i Ligjit). Zbatimi i pavarësisë financiare të Gjykatës në praktikë ka qenë një çështje tepër sfiduese, duke vënë në dukje se në shumicën e kohës është Ministria e Financave ajo e cila i përcakton kufijtë e përgjithshëm buxhetorë për të gjitha institucionet e pavarura duke përfshirë edhe Gjykatën. Megjithatë, tejkalimi i sfidave të tillë është bërë i mundshëm përmes një planifikimi afatmesëm, të elaboruar dhe arsyetuar. Gjykata ka mbajtur një kuotë të përafërt të buxhetit për tre vitet e zbatimit të planit strategjik. Gjykata ka hartuar me rregull raportet e shpenzimeve financiare sipas LMFPP-së dhe i ka publikuar ato në faqen zyrtare të saj (shih tabela 4). Shkalla e zbatimit të buxhetit gjatë tri viteve të kaluara është afër 100%.

³ Rregullore e Njësisë Ligjore Nr. 03/2019, e qasshme në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/Rregullore-03_2019_e-Njesis-Ligjore_shq.pdf

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Buxheti i alokuar/vlerësuar	1,541,513	1,698,779	1,957,723	1,886,960	1,864,753	1,835,354
Realizimi	1,527,569	1,697,490	1,957,335	1,886,805	/	/
Realizimi në %	99.13%	99.92 %	99.98%	99.99%	/	/

Tabela 4: Buxheti i vendosur dhe shpenzuar për Gjykatën për vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020 dhe buxheti i vlerësuar 2021 dhe 2022 (burimi: Raportet vjetore të Gjykatës, KASH-i 2020-2022)

Sa i përket auditimit të brendshëm, në aspektin e planifikimit, Gjykata ka hartuar planet periodike ashtu siç parashihet me legislacionin përkatës për auditimin e brendshëm, përfshirë Planin Strategjik Trevjeçar të auditimit të brendshëm, Planin Vjetor të auditimit të brendshëm dhe Planet tremujore të auditimit.

Qasja në dokumente publike sipas planit strategjik 2018-2021 ishte një nga objektivat që lidheshin me *garantimin e transparencës së çdo dokumenti publik duke iu referuar shpenzimeve të Gjykatës bazuar në LQDP*. Sipas këtij ligji, Gjykata është e obliguar të ofrojë qasje në dokumentet e saj sipas kërkesës. Në zbatim të këtij Ligji Gjykata, gjatë vitit 2018, kishte pranuar 10 kërkesa ndërsa gjatë vitit 2019 ka pranuar 23 kërkesa për qasje në dokumente publike. Gjykata i ka miratuar të gjitha këto kërkesa dhe se realizimi i këtij objektyvi e ka arritur shkallën 100% (shih tabela nr. 5).

Statusi	2018	2019
Miratuar pjesërisht	0	0
Miratuar plotësisht	10	23
Numri i përgjithshëm	10	23

Tabela 5: Kërkesat për qasje në Dokumente publike 2018, 2019 (burimi: raportet vjetore të Gjykatës)

5.5 Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Jashtë

Plani strategjik i Gjykatës 2018-2020 kishte evidentuar se Gjykata në të kaluarën është përballur me disa mangësi të lidhura me komunikimin me publikun. Sipas Planit Strategjik praktika e mëparshme e Gjykatës është treguar e pamjaftueshme dhe nuk ka një rrjedhë veprimi të qëndrueshme dhe të zbatuar mirë për të ngritur pozitën e saj në diskursin publik, me qëllim të rritjes së besueshmërisë së saj dhe për informimin më të mirë të palëve për të drejtat e tyre në Gjykatë. Njëri nga synimet kryesore ishte vendosja e një strategjie të mirëfilltë komunikimi.

Prandaj, gjatë viteve të fundit Gjykata ka intensifikuar punën e saj sidomos në rritjen e numrit dhe volumit të informatave të publikuara përmes ueb-faqes zyrtare të saj dhe formave të tjera të shpërndarjes së tyre. Ridizajnimi i faqes elektronike të Gjykatës dhe ofrimi i shumë opsiuneve të reja sidomos në filtrimin e rasteve ka mundësuar përmirësimin e komunikimit me publikun. Krahas kësaj, rekandohet një qasje më pro-aktive dhe zgjerim të përdorimit të metodave të komunikimit me publikun në përgjithësi dhe forcimin e bashkëpunimit me mediat. Kjo pjesë mbetet e një rëndësie të veçantë për strategjinë e ardhshme të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë është zhvilluar komunikim dhe bashkëpunim i rregullt edhe me Komisionin e Venecias. Po ashtu, stafi i Gjykatës ka marrë pjesë në numër të konsiderueshëm të vizitave zyrtare, vizitave studimore dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Janë ndërmarrë aktivitete për anëtarësimin e Gjykatës Kushtetuese në mekanizma ndërkombëtarë dhe rajonalë (shih tabela nr. 6). Anëtarësimi në mekanizma ndërkombëtarë mbetet i një prioriteti të lartë edhe për periudhën e ardhshme të Strategjisë së Gjykatës.

Produktet	2018	2019	2020
Raporte ditore të mediave	165	150	109
Raporte javore të mediave	52	51	47
Raporti vjetor i mediave	1	1	1
Raporte të mediave të shkruara për punën e Gjykatës	504	262	139
Raporte të mediave elektronike	894	720	1 258
Pyetje nga Mediat	228	181	372
Pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet	204	263	288
Fletushka/broshura etj.	Libri i dytë i GJK	Video animacione Video promovuese 3 broshura informative	1 Video animacion 1 Video promovuese
Buletini Informativ	Nr. 5 dhe 6	Nr.7 dhe 8	Nr. 9 dhe 10
Njoftime të publikuara për vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës	33	30	11
Njoftime për seanca dhe gjykime	12	12	//
Njoftime me informata përbledhëse përkitazi me vendimet e Gjykatës pas seancave shqyrtyuese	N/a	20	36
Vizita zyrtare në Gjykatë	27	28	3
Vizita zyrtare jashtë vendit	13	19	2
Punëtori/konferenca në vend	6	10	15
Punëtori/konferenca jashtë vendit	7	6	1
Qytetarë të regjistruar në recepcion	466	339	308
Përfaqësues institucionesh	145	244	29

Tabela 6: aktivitetet për komunikim dhe informim nga Gjykata gjatë viteve 2018-2019 (burimi: raportet vjetore të Gjykatës)

Matja e perceptimit të publikut për punën e Gjykatës nuk është bërë ndonjë herë as nga Gjykata e as nga ndonjë iniciativë tjeter e jashtme. Prandaj, rekomandohet krijimi i sistemit të matjes së besueshmërisë së qytetarëve për punën e Gjykatës nga ana e vetë Gjykatës ose në bashkëpunim me organizata të tjera.

5.6 Analiza SWOT

Analiza SWOT⁴ në vijim paraqet një vlerësim të pozicionit aktual të GJKK-së, si një bazë shtesë për hartimin e Strategjisë së GJKK-së për periudhën 2020-2025. Analiza është përgatitur mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga Raporti mbi Vlerësimin e zbatimit të Planit Strategjik të Gjykatës për periudhën 2018-2020 dhe punëtorisë së zhvilluar me personelin e Gjykatës kushtetuese ku kanë marrë pjesë gjyqtarët. Informatat e siguruara nga raporti i vlerësimit dhe SWOT-i ndër të tjera kanë shërbyer për të përcaktuar qëllimet strategjike dhe masat e zbatimit për periudhën e ardhshme afatmesme.

	POZITIVE	NEGATIVE
Te brendshme	<p>Pikat e forta (Strengths):</p> <ul style="list-style-type: none"> Pavarësia organizative, administrative e financiare e institucionit; Staf profesional dhe i kualifikuar në mbështetje të gjyqtarëve; Gatishmëria dhe përkushtimi i liderishtipit të Gjykatës dhe gjyqtarëve për zhvillimin afatgjatë të Gjykatës dhe rritjen e performancës institucionale; Staf i motivuar për t'u përballur me sfidat e Gjykatës; Funksionimi i sistemit përmenaxhimin e rasteve; Përvoja dhe praktika e krijuar në planifikim strategjik përmenaxhimin e Gjykatës dhe monitorim të zbatimit; Ambiente të përshtatshme përmenaxhim; Zbatimi konsistent i praktikës së brendshme gjyqësore dhe GJEDNJ; Tranzicioni i lehtë gjatë ndërrimeve të gjyqtarëve; Literatura dhe burimet e brendshme që tanë ka Gjykata (biblioteka); Trajnimet e vazhdueshme të stafit të Gjykatës; Rritja e kuantitetit të analizës së vendimeve të Gjykatës; Pozita e Juriskonsultit si pozitë e re në Njësinë Ligjore. 	<p>Mangësitë (Weaknesses):</p> <ul style="list-style-type: none"> Nevoja për një plan të qëndrueshëm gjithëpërfshirës afatmesëm përmenaxhim; Mungesa e një rregulloreje përmenaxhim me median dhe publikun; Qarkullim i këshilltarëve kushtetues juridikë të Njësisë Ligjore; Numër i pamjaftueshëm i këshilltarëve kushtetues juridikë; Aktvendimet shumë të gjata; Mungesa e klasifikimit të rasteve në procedurë të pranimit mundëson kalimin e shumë rasteve të cilat mund të mos jenë relevante; Numër i madh i akteve të brendshme që krijon mungesa konsistencë dhe kolizion të dispozitave; Komunikimi i brendshëm në Gjykatë; Komponenti i hulumtimit jo i mjafqueshëm; Mungesa e instrumenteve përmenaxhim; Mungesa e përdorimit te CDMS nga Gjykata përvëç njësisë së regjistrimit; Lidhja e CDMS me ueb faqen; Mungesa e shablonëve/formularëve përmenaxhim; Rritja e numrave të rasteve brenda sistemit / standardizimi i shkresave të Gjykatës / ndërlidhja me sistemin e menaxhimit të rasteve.
Te jashtme	<p>Mundësitë (Opportunities)</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja teknike nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë; Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe shkëmbimi me gjykata simotra në rajon dhe më gjerë; Besimi i qytetarëve dhe publikut tek Gjykata; Rritja e kualitetit te kërkeseve që drejtohen tek Gjykata; Zgjerimi i përdorimit të praktikës së GJEDNJ-së; Mundësia e angazhimit të ekspertëve të jashtëm përmenaxhim specifice përmenaxhim; Përdorimi i citimeve të GJEDNJ-së dhe vendeve të tjera në përmenaxhim; Mundësia që ofron teknologjia ne digitalizim të proceseve (automatizimi i sistemit te menaxhimit të rasteve); Rritja e kompleksitetit të rasteve; Eksplorimi i mëtejshëm i mundësive të edukimit të publikut përmenaxhim; 	<p>Kërcënimet (threats):</p> <ul style="list-style-type: none"> Rritja e numrave të rasteve dhe kompleksitetit të tyre; Presionet politike dhe mediatike; Mosrespektimi i pavarësisë organizative dhe financiare të Gjykatës nga institucionet e tjera; Tendenca përmenaxhim e Ligjit përmenaxhim; Kuvend pa e konsultuar Gjykatën si palë të interesuar; Ndryshimet e shpeshta ligjore; Të kuptuarit jo i drejtë i publikut përmenaxhim; Moskuptimi i rolit të Gjykatës nga institucionet; Mos përgjigja e rregullt e institucioneve ndaj kërkeseve të Gjykatës; Ndikimi i zhvillimeve ekonomike në buxhetin e ardhshëm të Gjykatës; Ndikimi i Pandemisë COVID-19; Mundësia e moszbativit të vendimeve të Gjykatës; Mundësia e qarkullimit të stafit profesional; Vonesat potenciale të emërimit të gjyqtarëve të rinj nga ana e Kuvendit; Tentim qasja dhe ndërhyrje në të dhënat e brendshme dhe komunikimet e Gjykatës.

⁴ Kjo SWOT analizë është përgatitur bazuar në vlerësimin e zbatimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për Periudhën 2018-2020, si dhe punëtorinë e zhvilluar me gjyqtarët dhe personelin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 1 dhe 2 tetor 2020.

6 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

6.1 Përmirësimi i Kornizës Ligjore

Qëllimi Strategjik 1: Avancimi i cilësisë dhe zbatimit të kornizës ligjore

Objektivi Specifik 1.1. Avancimi i kapaciteteve të Gjykatës për të ndikuar në procesin legjislativ që ndikon në funksionimin dhe pavarësinë e Gjykatës;

Objektivi Specifik 1.2. Plotësimi, harmonizimi dhe konsolidimi i kornizës së brendshme rregullative;

Objektivi Specifik 1.3. Avancimi i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin efektiv të rregullativës së brendshme të Gjykatës.

Objektivi Specifik 1.1. Avancimi i kapaciteteve të Gjykatës për të ndikuar në procesin legjislativ që ndikon në funksionimin dhe pavarësinë e Gjykatës

Avancimi i mekanizmave përmes të cilëve Gjykata jep kontributin ose intervenon gjatë hartimit të akteve të reja ligjore të cilat cenojnë pavarësinë saj, éshtë një faktor i rëndësishëm për funksionim të mirëfilltë të Gjykatës. Si rezultat, Gjykata do të vazhdojë qasjen të cilën e ka praktikuar deri më tanë në këtë drejtim por me synimin e rritjes së kapaciteteve të përgjithshme për të identifikuar ndryshimet e mundshme dhe shqyrtimin e mekanizmave të rinx shtesë që kontribuojnë drejt arrijes me sukses të këtij objektivi.

Si aktivitet i vazhdueshëm që Gjykata do të aplikojë éshtë monitorimi i procesit të hartimit të legjislacionit të ri nga Kuvendi, që si rezultat do të ketë identifikimin e akteve ligjore dhe dispozitive të cilat eventualisht mund të ndikojnë në pavarësinë e Gjykatës. Kjo do të bëhet përmes përdorimit të tabelës së monitorimit (*monitoring chart*) në të cilën përfshihen dhe rregullisht mirëmbahet lista e ligjeve të cilat janë në Programin legjislativ të Qeverisë, të cilat janë identifikuar si projektligje që mund të ndikojnë në punën e Gjykatës.

Mënyra e reagimit të Gjykatës dhe mekanizmi që ajo përdor për të kontribuar dhe dhënë komente me qëllim të përmirësimit të projekt akteve ligjore varet nga faza procedurale e hartimit dhe miratimit në të cilën gjendet një projekt-akt ligjor si dhe reagimi i institucioneve bartëse për hartimin dhe miratimin e tyre. Gjykata në nivel ekspertësh do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ofrimin e komenteve dhe rekondimeve nëse një akt ligjor éshtë në fazën e hartimit në grupet punuese, ose përmes procesit të konsultimit publik elektronik të cilin e përdor Qeveria dhe dikasteret e saj⁵. GJKK me qëllim të përmirësimit të projekt ligjeve në kontekst të ruajtjes së pavarësisë së saj, mund të organizojë takime të përbashkëta me institucionet qeveritare ose takime me komisionet përkatëse parlamentare të Kuvendit. Gjithashtu sipas nevojës mund të organizojë aktivitete të tjera si konferanca sensibilizuese, debate me grupe të caktuara profesionale etj.

Objektivi Specifik 1.2. Plotësimi, harmonizimi dhe konsolidimi i kornizës së brendshme rregullative

Gjykata sipas Kushtetutës⁶ ka lirinë për të rregulluar çështjet e brendshme përfshirë edhe miratimin e akteve nënligjore të cilat ia mundësojnë asaj funksionimin efikas dhe të pavarur.

⁵ Platforma elektronike për konsultim publik përmes të cilës mund të jepen komente dhe rekondime për projekt aktet ligjore, nënligjore dhe draft politikat dhe strategjitë: <https://konsultimet.rks-gov.net>

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 115. 1. përcakton se “Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin”.

Për këtë qëllim gjatë viteve të kaluara të funksionimit të saj Gjykata ka hartuar 21 akte të brendshme në formën e rregulloreve, udhëzimeve administrative, udhëzimeve praktike dhe kodit të mirësjelljes për gjyqtarë. Situata praktike dhe analizat e brendshme kanë identifikuar disa aspekte harmonizuese që duhet të bëhen në periudhën e ardhshme strategjike⁷. Si rezultat, është shtuar nevoja e fillimit të një procesi të planifikuar dhe të koordinuar për harmonizimin dhe konsolidimin teknik të akteve të brendshme. Varësisht nga numri i akteve të cilat duhet të harmonizohen, Gjykata do të vlerësojë mundësinë e bashkimit të disa akteve në akte gjithëpërfshirëse dhe të konsoliduara ashtu që të ulet numri i tyre dhe të rritet efektiviteti i zbatimit praktik të tyre.

Gjykata gjithashtu synon të përmirësojë cilësinë e akteve të brendshme të Gjykatës duke vendosur një sistem dhe rregulla procedurale të cilat mundësojnë koordinim më të mirë, përfaqësimin e duhur të të gjitha segmenteve të Gjykatës dhe konsultimin e brendshëm gjatë hartimit të tyre.

Objktivi Specifik 1.3. Avancimi i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin efektiv të rregullativës së brendshme të Gjykatës

Harmonizimi dhe konsolidimi i kornizës së brendshme rregulative por edhe krijimi i një sistemi të brendshëm i cili mundëson konsultim, koordinim më të mirë gjatë hartimit të tyre siç është synuar përmes objektivit specifik paraprak 1.2. janë parakushte që ndikojnë në shkallën e zbatimit të tyre. Hap tjetër që rrit efektivitetin e zbatimit të kornizës së brendshme është publikimi i tyre dhe ofrimi i qasjes jo vetëm brenda Gjykatës por edhe publikut të gjërë. Faktorë me rëndësi që ndikojnë në shkallën e zbatimit të akteve të brendshme janë procedurat e qarta dhe mekanizmat funksional për shqyrtimin e ankesave dhe masave për shkeljet e mundshme të akteve të brendshme dhe atij të aplikueshëm për stafin e Gjykatës. Funksionimi i sistemit për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, aplikimi i standardeve për planifikim të punës në nivel të njësive organizative, në nivel të zyrtarëve dhe vlerësimit të performancës së tyre janë gjithashtu disa faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në zbatimin e akteve të Gjykatës.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi Strategjik 1: Avancimi i cilësisë dhe zbatimit të kornizës ligjore			
Treguesit	Vlera bazë (baseline)	Caku 2023	Caku 2025
1. Numri i ligjeve në të cilat Gjykata ka marrë pjesë në mënyrë proaktive.	3	Në varësi të agjendës Legjislative	Në varësi të agjendës Legjislative
Objktivi Specifik: 1.2. Plotësimi, harmonizimi dhe konsolidimi i kornizës së brendshme rregulative			
1. Numri i akteve të brendshme të plotësuara dhe ndryshuara;	0	17	5
2. Numri i rekomandimeve për plotësimin dhe ndryshimin e rregullativës së brendshme.	21	3 (gjatë secilit vit)	5 (gjatë secilit vit)
Objktivi Specifik: 1.3. Avancimi i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin efektiv të rregullativës së brendshme të Gjykatës			
1. Numri i rregulloreve të zbatuara në mënyrë efektive;	1	Të gjitha	Të gjitha

⁷ Raporti mbi vlerësimin e kornizës rregulative të brendshme, dhjetor 2019 - prill 2020. Dokument i pa publikuar.

2. Publikimi i të gjitha akteve të brendshme në uebfaqen e Gjykatës.	2	Të gjitha aktet e publikuara	Të gjitha aktet e publikuara

6.2 Cilësia dhe Efikasiteti i Vendimeve të Gjykatës

Qëllimi Strategjik 2: Rritja e vazhdueshme e cilësisë së vendimeve dhe efikasitetit të vendimmarrjes së Gjykatës

Objktivi Specifik 2.1. Rritja e cilësisë së vendimeve të Gjykatës duke siguruar konsistencë të praktikës së brendshme dhe duke përmirësuar referencën në praktikën gjyqësore ndërkombëtare;

Objktivi Specifik 2.2. Forcimi i kapaciteteve të Njësisë Ligjore, me theks të veçantë në fushën e hulumtimit profesional;

Objktivi Specifik 2.3. Avancimi i sistemit të menaxhimit të rasteve përmes koordinimit, thjeshtësimit administrativ të procedurave si dhe avancimit të mëtejmë të CDMS-së.

Objktivi Specifik 2.1 Rritja e cilësisë së vendimeve të Gjykatës duke siguruar konsistencë të praktikës së brendshme dhe duke përmirësuar referencën në praktikën gjyqësore ndërkombëtare

Cilësia e vendimeve gjyqësore përveç faktorëve të jashtëm varet gjithashtu nga faktorë të brendshëm, siç janë profesionalizmi i gjyqtarëve, procedurat e brendshme, aftësitë hulumtuese dhe analitike të Njësisë Ligjore, konsolidimit të praktikës nga Juristkonsulti, cilësia e menaxhimit të rasteve, seancat dëgjimore dhe kualiteti i drafteve të hartuara. Analiza e qartë, gjithëpërfshirëse, si dhe arsyetimi i vendimeve janë kërkesa themelore për cilësi të vendimeve gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës për gjykim të drejtë.⁸ Konsistenza e aplikimit të legislacionit, ruajtja dhe forcimi i praktikës gjyqësore të brendshme si dhe zgjerimi i aplikimit të praktikës më të fundit gjyqësore ndërkombëtare të aplikueshme janë elemente thelbësore për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore.

Përveç kësaj, faktor tjetër i rëndësishëm i cili lidhet më cilësinë e vendimeve të Gjykatës është përdorimi i praktikës gjyqësore ndërkombëtare, e në veçanti përqendrim më i madh duhet të ketë përdorimi i praktikës më të re gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe referimi i KEDNJ-së nga pikëpamja më e gjerë e të drejtave të njeriut. Fakti që e drejta për një gjykim të drejtë është çështja më e diskutuar para Gjykatës mund ta bëjë këtë të shqyrtojë ankesat kryesisht nga perspektiva e nenit 6 të KEDNJ-së, në vend që të analizojë referimin në një këndvështrim më të gjerë dhe në dritën e të drejtave të tjera të njeriut⁹. Në kontekstin e analizave dhe gjetjeve të ekspertizës së Këshillit të Evropës, Gjykata më tutje do të shqyrtojë mundësinë e "eksplorimit" të përfshirjes së praktikës gjyqësore përkitazi me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, lirinë e fesë, lirinë e shprehjes, lirinë e asociimit dhe të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Mund të supozohet se kjo situatë reflekton vetëdijesim jo të mjaftueshëm për të drejtat e tillë si dhe mungesën e ekspertizës së mjaftueshme të avokatëve

⁸ Opinion no.11 (2008) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) për vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore. Shih adresën: http://www.euromed-justice.eu/en/system/files/20100716094018_10.CCJE_OPn11.pdf

⁹ Trajkovska, Mirjana Lazarova. (2020). Vlerësimi i implementimit të KEDNJ-së nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Këshilli i Evropës. Raport i Brendshëm.

në fushat e lartpërmendura.¹⁰ Ndonjëherë "proceset gjyqësore strategjike" në disa prej këtyre fushave mund të sigurohen në fazën e pranueshmërisë¹¹. Përmirësimit të cilësisë në kontekstin e përdorimit të praktikës më të mirë gjyqësore do t'i kontribuojë edhe referimi në praktikën e gjykatave simotra në vendet e tjera. Për më tepër, marrë parasysh që Kosova është në proces të integrimit evropian, përgatitja e Gjykatës për të përdorur praktikën gjyqësore të GJDBe-së dhe fillimi i përdorimit të saj do të bëhet gjatë periudhës kohore të cilën e mbulon kjo Strategji.

Gjykata duhet të konsiderojë trajtimin e rasteve në meritë, qoftë edhe duke nxjerrë Aktgjykime pa shkelje, në vend që të njëjtat të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. Një vendim mbi meritat do të siguronte më mirë palët se çështja e tyre është dëgjuar siç duhet dhe, në këtë mënyrë, do të kontribuonte në pranimin më të mirë të vendimit të Gjykatës.¹² Kjo gjithashtu do të ulte numrin e vendimeve për papranueshmëri i cili edhe ashtu është shumë i lartë. Në funksion të kësaj, Gjykata do të hartojë Udhëzimin për procedurën dhe organizimin e punës së Gjykatës lidhur me pranimin, regjistrimin dhe përcjelljen e kërkesave për shqyrtim si dhe arkivimin e lëndëve nga ana e GJKK-së, e cila pritet të ndikojë në rritjen e efikasitetit të punës. Bashkëpunimi i shtuar me Odën e Avokatëve, Avokatin e Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile do të ndihmojë në rritjen e njoħurive për juridiksionin e Gjykatës dhe si rezultat shmangien e paraqitjes së rasteve për të cilat Gjykata nuk është kompetente.

Në kontekstin e përmirësimit të përdorimit të praktikës gjyqësore, avancimi i kapaciteteve dhe mekanizmave për kërkim dhe zhvillim të mëtejshëm është i domosdoshëm. Definimi praktik i rolit dhe përgjegjësive të pozitës së Juristkonsultit në kuadër të Gjykatës dhe roli aktiv i kësaj pozite në zgjerimin e hulumtimit dhe dhënia e kontributit të tij/saj në secilin rast mund të rrisë kualitetin e vendimeve nga aspekti i ruajtjes se konsistencës dhe përdorimit të praktikës gjyqësore të brendshme dhe ndërkombëtare. Kontribut në këtë drejtim do të jap edhe finalizimi dhe miratimi i Udhëzuesit për unifikimin e përdorimit të standardeve të citimit në vendimet e Gjykatës përfshirë vendimet e gjykatave më të ulëta dhe gjykatave ndërkombëtare.

Avancimi i sistemit të menaxhimit të rasteve e sidomos integrimi i sistemit ekzistues elektronik, (në excel) me Sistemin Elektronik të Menaxhimit të rasteve është një instrument i rëndësishëm i cili i shërben Njësisë Ligjore dhe gjyqtarëve në identifikimin dhe përdorimin më të lehtë të praktikës së mëhershme gjyqësore.

Në anën tjetër, përdorimi i udhëzuesve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) mund të ndihmojë në identifikimin dhe përdorimin e mekanizmave dhe praktikave ndërkombëtare të cilët do të ndikojnë në cilësinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.¹³

Objektivi Specifik 2.2. Forcimi i kapaciteteve të Njësisë Ligjore, me theks të veçantë në fushën e hulumtimit profesional

Është me rëndësi kyçe avancimi i mëtejmë i kapaciteteve kërkimore të stafit të Njësisë Ligjore, marrë parasysh se funksioni kryesor i saj është përgatitja profesionale e rasteve, përfshirë këtu mbështetjen e punës profesionale te gjyqtareve, duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër ligjor në mbështetje të punës së gjyqtarëve të Gjykatës dhe detyra të tjera relevante të caktuara¹⁴.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Ibid. Referencë është bërë në rastin KI108/18, me parashtruese Blerta Morina, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 shtatorit 2019.

¹² Ibid.

¹³ <https://rm.coe.int/komisioni-evropian-per-efikasitetin-e-drejtësise-cepei-matja-e-cilesis/16807477ca>
dhe <https://www.coe.int/en/web/cepej/cepej-work/quality-of-justice>

¹⁴ Neni 2.2. i Rregullores së Njësisë Ligjore Nr.03/2019

Sipas Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë “*Cilësia e arsimit dhe trajnimit juridik të gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjera juridikë janë të një rëndësie të madhe në sigurimin e një vendimi gjyqësor me cilësi të lartë*”.¹⁵ Njësia ligjore është boshti kryesor profesional i Gjykatës dhe profesionalizmi i stafit të saj është faktor kryesor për të siguruar vendime cilësore. Analiza SWOT nxjerrë në pah se Gjykata ka staf profesional dhe të kualifikuar në mbështetje të gjyqtarëve. Përveç kësaj, motivimi i tyre së bashku me përvojën e krijuar dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së analizës janë evidentuar si pika të forta të Njësisë Ligjore. Megjithatë, zhvillimet e reja dhe avancimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës, zhvillimet e reja të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe nevoja për referim të praktikës së GJDBe-së si rezultat i procesit te integrimit evropian të Kosovës, kërkon forcim dhe avancim të mëtejmë të kapaciteteve profesionale për stafin e Njësisë Ligjore. Për këtë qëllim kërcohët që paraprakisht të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave për ngritje të kapaciteteve të Njësisë Ligjore i cili pastaj duhet përcjellë me një plan afatmesëm dhe programe të trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera. Nevoja për një plan të qëndrueshëm gjithëpërfshirës afatmesëm për ngritjen e kapaciteteve bazuar në vlerësim të nevojave është cekur edhe përmes analizës SWOT. Në veçanti është e nevojshme të bëhet vazhdimi i bashkëpunimit me Këshillin e Evropës për dërgimin e këshilltarëve dhe gjyqtareve në GJEDNJ në kohëzgjatje prej disa muajsh. Rritjes së kapaciteteve të mëtejme të stafit të Njësisë Ligjore i kontribuon zgjerimi i bashkëpunimit më organizata të tjera ndërkombëtare dhe gjykatat kushtetuese simotra, sidomos të vendeve evropiane dhe atyre të rajonit.

Megjithëse konsiderohet se Gjykata për nga numri ka staf të cilët mund të përballojnë vëllimin e punës, duke pasur parasysh faktin që niveli i vështirësisë së rasteve është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe se numri i rasteve të paraqitura mund të rritet në të ardhmen, rritja e numrit të këshilltarëve në periudhën e ardhshme afatmesme është e domosdoshme. Ky supozim mbështetet edhe nga analiza SWOT ndërsa argument në favor të shtimit të përpjekjeve për rritjen e numrit të këshilltarëve rrjedh edhe nga qarkullimi i lartë i stafit gjatë periudhës së kaluar pesë vjeçare. Nga viti 2015 disa këshilltarë nga Njësia Ligjore e kanë lëshuar vandin e punës dhe të tjerë të rinj janë punësuar për të bërë zëvendësimet e nevojshme.

Pozita e Juristkonsultit e përcaktuar me Rregulloren Nr. 03/2019 e Njësisë Ligjore luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së vendimeve përmes hulumtimit të mëtejmë të praktikës gjyqësore të brendshme dhe ndërkombëtare dhe reflektimit të tyre në vendimet që janë në procedurë. Prandaj në periudhën e ardhshme afatmesme kërcohët mbështetja e kësaj pozite dhe forcimi i saj në fushën e hulumtimit dhe kërkimit.

Gjatë përgatitjes së rasteve për shqyrtim, gjyqtarët kanë nevojë për informata, analiza dhe hulumtime shtesë për tema të caktuara të cilat janë me interes dhe që ndihmojnë në rritjen e kualitetit të analizës së tyre. Një angazhim të tillë është e vështirë ta marrin përsipër këshilltarët të cilët janë vazhdimisht të ngarkuar me përgatitjen dhe ofrimin e këshillave për rastet të cilat janë në procedurë në Gjykatë. Prandaj shqyrtimi i mundësisë së zhvillimit të një dege të veçantë të hulumtimit për tema të tilla brenda Njësisë Ligjore konsiderohet si e dobishme dhe e nevojshme. Në shërbim të kësaj, dhe me qëllim të shfrytëzimit më racional të burimeve ekzistuese të brendshme dhe të jashtme, Gjykata mund të bashkëpunojë edhe me organizata të ndryshme të specializuara për hulumtime, qoftë ato të shoqërisë civile, donatorë apo të tjera. Zhvillimi i hulumtimeve dhe studimeve kërkon burime financiare dhe njerëzore prandaj duhet një planifikim vjetor apo afatmesëm, përmes të cilit përcaktohen temat e studimeve dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Kjo ndihmon në identifikimin e burimeve financiare dhe burimeve të tjera të nevojshme të cilat kërkojnë planifikim dhe përgatitje paraprake.

¹⁵ Opinion no.11 (2008) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) për vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore. Shih adresën: http://ee.euromed-justice.eu/en/system/files/20100716094018_10.CCJE_.OPn11.pdf

Objktivi Specifik 2.3. Avancimi i sistemit të menaxhimit të rasteve përmes koordinimit, thjeshtësimit administrativ të procedurave si dhe avancimit të mëtejshmë të CDMS-së

Konsiderohet se janë të domosdoshme mjetet adekuate të teknologjisë informative për të mbështetur monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të Gjykatës, me qëllim të përmirësimit të performancës së saj. Kjo gjë mund të bëhet duke evidentuar mangësitë dhe nevojat, në sigurimin e menaxhimit të çështjeve në kohë reale, statistikat e standardizuara të Gjykatës, menaxhimin e numrit të lëndëve të grumbulluara dhe sistemet e automatizuara të paralajmërimit të hershëm.¹⁶ Gjykata tashmë ka në funksion sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve i cili është ndërtuar në vitin 2015. Pas një rishikimi të sistemit të bërë nga ana e një ekipi të mbështetur nga Këshilli i Evropës¹⁷ konsiderohet se është i nevojshëm përditësimi i tij në pajtim me gjetjet dhe rekomandimet e këtij vlerësimi si dhe me standardet e Udhëzuesit të CEPEJ Cyberjustice.¹⁸ Qëllimi kryesor sipas vlerësimit është të modernizohen proceset e punës dhe të përmirësohet CDMS duke e bërë atë mjet referimi për të punuar në raste. Përveç tjerash synohet që shablonet dhe Memo-ja për përcaktimin e afateve për shqyrtim të rasteve të ndërlidhen në mënyrë elektronike me sistemin e menaxhimit të rasteve, pastaj ndërlidhja e CDMS me ueb faqen zyrtare të Gjykatës në segmentet që është e nevojshme, sigurimi i mjeteve përritjen e sigurisë kibernetike etj.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi Strategjik 2. Rritja e cilësisë së vendimeve dhe efikasitetit të vendimmarrjes së Gjykatës				
Treguesit	Vlera bazë (baseline)	Caku 2023	Caku 2025	
1. Numri i vendimeve që përbajnjë referenca në praktikën e përditësuar të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së;	Vendime (150)	190	230	
2. Numri i vendimeve që përbajnjë referenca në praktikën e përditësuar të gjykatave kushtetuese simotra;	Vendime (15)	20	25	
3. Numri i vendimeve që përbajnjë referenca në vendimet e GJDBE-së;	Vendime (2)	16	30	
4. Përqindja e përfundimit të rasteve të paraqitura në Gjykatë.	52.6%			
Objktivi Specifik: 2.2. Forcimi i kapaciteteve të Njësisë Ligjore, me theks të veçantë në fushën e hulumtimit profesional				
1. Numri i trajnimeve të mbajtura për draftim dhe tema specifike nga ekspertë që ndërlidhen me të drejtat e njeriut, praktikën gjyqësore kushtetuese si dhe praktikën e GJEDNJ-së dhe GJDBE-së;	10 (trajnime)	22 (çdo vit)	22 (çdo vit)	
2. Numri i hulumtimeve specifike përkitazi me rastet në shqyrtim para Gjykatës.	9 (hulumtime)	33	33	

¹⁶ Komisioni Evropian, Semestri Evropian Përbledhja Tematike Sistemet efektive të Drejtësisë. 2016. Shih adresën:https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/european-semester_thematic-factsheet_effective-justice-systems_en.pdf

¹⁷ Vlerësimi i nevojave për menaxhimin e çështjeve dhe hulumtimet ligjore për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Raport i Brendshëm i përkrahur nga projektii "Përmirësimi i Mbrotjes së Standardeve Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga Gjykata Kushtetuese".

¹⁸ CEPEJ(2019)7, shih adresën: <https://rm.coe.int/cepej-toolkit-cyberjustice-en-cepej-2019-7/168094ef3e>

Objektivi Specifik: 2.3. Avancimi i sistemit të menaxhimit të rasteve përmes koordinimit, thjeshtësimit administrativ të procedurave si dhe avancimit të mëtejmë të CDMS-së				
1. Koha mesatare e shqyrtimit të rasteve të paraqitura në Gjykatë;		9 muaj	7 muaj	
2. Rritja e përdorimit të CDMS-së për menaxhim të rasteve.	17 %	99%		

6.3 Burimet Njerëzore dhe Struktura Organizative

Qëllimi Strategjik 3: Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve njerëzore dhe strukturës organizative të Gjykatës

Objektivi Specifik 3.1. Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve të stafit profesional dhe shërbimeve të mbështetjes së Gjykatës përmes planifikimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit

Objektivi Specifik 3.2. Konsolidimi i një praktike të mirë në lidhje me komunikimin e brendshëm

Objektivi Specifik 3.3. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit të Gjykatës përmes programeve të shkëmbimit

Objektivi Specifik 3.4. Përmirësimi i mëtejmë i strukturës organizative të Gjykatës

Objektivi specifik 3.1. Zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve të stafit profesional dhe shërbimeve të mbështetjes së Gjykatës përmes planifikimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit

Vlerësimi i nevojave për trajnime të stafit të Gjykatës, përfshirë stafin e Njësisë Ligjore, stafin e kabinetit të kryetarit/es ashtu edhe personelit kushtetues administrativ, éshtë pikënisja e aktiviteteve që ndërlidhen më zhvillimin e mëtejmë të kapaciteteve të Gjykatës. Vlerësimi i nevojave për trajnime përmes formave të vlerësimit përmes të cilave të vlerësuarit dhe vlerësuesit bashkërisht vendosin nevojat për trajnime éshtë një nga mundësítë që ofrohen përmes sistemit të vlerësimit i cili éshtë bërë nga Gjykata në vazhdimësi. Megjithatë, një vlerësim i tillë nuk ofron informata të mjaftueshme gjithëpërfshire për një planifikim afatmesëm së paku tre vjeçar për ngritjen e kapaciteteve. Prandaj vlerësimi i nevojave të stafit sipas një metodologjje standarde apo specifike të vlerësimit do të përmirësojë segmentin e planifikimit të trajnimeve. Ky planifikim do të jetë gjithëpërfshire për gjithë stafin e Gjykatës. Plani i trajnimeve do të pasohet nga hartimi dhe zbatimi i programeve për trajnime specifike dhe për tema të përgjithshme, zbatimi i të cilave mund të komplementohet nga programe të njëjtë që organizohen nga administrata publike apo sistemi gjyqësor. Prandaj, përvèç nevojës që organizimi dhe financimi i trajnimeve të bëhet përmes mjeteve buxhetore të cilat i ka Gjykata në dispozicion, një pjesë e trajnimeve sidomos trajnimet e përgjithshme që lidhen më funksionimin e administratës publike në tërsi mund të mbahen nga institucione përgjegjëse për mbajtjen e trajnimeve, siç éshtë IKAP-i apo ato që lidhen më sistemin gjyqësor nga Akademia e Drejtësisë. Plani afatmesëm i trajnimeve bazuar në nevojat e gjykatës mund të shërbej edhe si një mjet përmes të cilit mund të mobilizohen resurset e donatorëve për të mbuluar boshllékun buxhetor si rezultat i mungesës së mjeteve buxhetore të GJKK-së. Zbatimi i planit të trajnimeve duhet të pasohet nga një vlerësim i ndikimit të trajnimeve të mbajtura, dhe do t'i paraprijë një cikli të ri të planifikimit të avancimit të kapaciteteve më tutje.

Efikasiteti dhe efektiviteti i trajnimeve dhe politikat të cilat Gjykata do të zbatojë në këtë segment, por edhe për menaxhimin e burimeve njerëzore në dimension më të gjerë do të varen edhe nga disponueshmëria e informatave, mënyra e menaxhimit të tyre dhe mjetet që përdorën për këtë qëllim. Prandaj, gjatë periudhës së ardhshme planifikuese Gjykata do të zhvillojë një sistem të përshtatshëm elektronik përmes të cilit do menaxhojë trajnimet por edhe burimet njerëzore në tërësi.

Objktivi specifik 3.2. Konsolidimi i një praktike të mirë në lidhje me komunikimin e brendshëm

Komunikimi i brendshëm dhe transparenca mes stafit të Gjykatës është segment që kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Me qëllim të përmirësimit të transparencës së brendshme të aktiviteteve të Gjykatës është bërë informimi i rregullt mëjor i gjyqtarëve, Sekretariatit dhe Njësisë Ligjore për kërkesa/pyetje të mediave/qytetarëve, kërkosat e parashtruara nga Komisioni i Venecias, kërkosat për qasje në dokumente, vizita në Gjykatë, numri i vizitorëve, si dhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare etj. Ky objektiv specifik ndërlidhet me shumicën e objektivave të tjera të Strategjisë. Hartimi i një akti nënligjor apo procedure standarde operative për komunikim të brendshëm do të qartësojë vijat e komunikimit të brendshëm dhe ngritjen e nivelit të përgjegjësisë që lidhen me koordinimin dhe komunikimin e brendshëm. Përveç kësaj, mund të zhvillohen udhëzues për përdorim të emailit zyrtar dhe sistemeve elektronike të tjera të komunikimit. Një mekanizëm që mund të luajë rol të rëndësishëm edhe si kontribut në përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit të brendshëm do të jetë themelimi i një grupei integruar të planifikimit të punës, buxhetit si dhe monitorimit të zbatimit të tyre. Gjithashtu, rregullimi i koordinimit të brendshëm, qartësimi i roleve dhe përgjegjësive për qëllime të përmirësimit të komunikimit me mediat dhe publikun do të luajë rol në konsolidimin e një praktike të mirë për komunikimin e brendshëm.

Objktivi specifik 3.3. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit të Gjykatës përmes programeve të shkëmbimit

Përvoja e kaluar e zbatimit të programeve të vendosjes së stafit të Gjykatës Kushtetuese, përfshirë gjyqtarë, këshilltarë juridikë dhe drejtore, në GjEDNJ është treguar shumë efikase për ngritjen e kapaciteteve të tyre në aplikimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Vazhdimi i një praktike të tillë do të jetë një nga mundësítë e cila do të shfrytëzohet edhe në të ardhmen. Do të shtohen përpjekjet për shqyrtimin e mundësive për programe të tjera të shkëmbimit me gjykata të tjera të vendeve të rajonit, vende të tjera të Evropës Perëndimore, si dhe programe dhe mekanizma të tjera multilateral.

Objktivi specifik 3.4. Përmirësimi i mëtejmë i strukturës organizative të Gjykatës

Procesi i plotësimit të strukturës organizative gjatë viteve të fundit është shoqëruar nga plotësime me pozita të reja apo punësim të stafit në pozitat ekzistuese, transferime, riemërimë apo promovime individuale të stafit, por për ndryshime në strukturë nuk është shfaqur nevoja të bëhen. Në vazhdim, vlerësohet se një ristrukturim apo ndryshim thelbësor i strukturës organizative të Gjykatës nuk është i nevojshëm pasi që struktura organizative e tashme e Gjykatës i përgjigjet nevojave të Gjykatës. Megjithatë, nevojat për ndryshime dhe përmirësimë të strukturës, do të janë gjithmonë evidente si rezultat i zhvillimeve të reja. Prandaj, adresimi i nevojave eventuale për ndryshime kërkojnë dhe do të bëhen duke përcjellë një qasje analitike të bazuar në analiza dhe shqyrtim të alternativave më të mira të cilat mund t'i shërbejnë arritjes së objektivave të Gjykatës dhe zbatimit të mandatit të saj.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi Strategjik 3: Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve njerëzore dhe strukturës organizative			
Objektivi Specifik: 3.1. Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve të stafit profesional dhe shërbimeve të mbështetjes së Gjykatës përmes planifikimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit			
Treguesit	Vlera bazë (baseline)	Caku 2023	Caku 2025
1. Numri i trajnimeve të organizuara për zhvillim profesional të stafit të Gjykatës;	3 (trajnime)	12 (ne baza vjetore)	12 (ne baza vjetore)
2. Numri i trajnimeve të organizuara për stafin e shërbimeve të mbështetjes administrative;	3 (trajnime)	40 (ne baza vjetore)	40 (ne baza vjetore)
3. Numri i stafit të trajnuar.	22 (zyrtarë)	70 (ne baza vjetore)	70 (ne baza vjetore)
Objektivi Specifik: 3.2. Konsolidimi i një praktike të mirë në lidhje me komunikimin e brendshëm			
1. Numri i njoftimeve drejtuar stafit lidhur me aktivitetet e brendshme të Gjykatës;	/	/	/
2. Përmirësimi i komunikimit të brendshëm të stafit.	/	/	/
Objektivi Specifik: 3.3. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit të Gjykatës përmes programeve të shkëmbimit			
1. Numri i pjesëmarrësve në programet e shkëmbimit të përvojave;	1	6 (vjetore)	6 (vjetore)
2. Numri i pjesëmarrjes në aktivitetet regionale/ndërkombëtare;	1	6(vjetore)	6 (vjetore)
3. Numri i vizitave studimore.	1	6(vjetore)	6 (vjetore)
Objektivi specifik 3.4. Përmirësimi i mëtejmë i strukturës organizative të Gjykatës			
1. Analizimi dhe plotësimi i strukturës organizative.	2	Sipas nevojës	Sipas nevojës

6.4 Menaxhimi i Financave dhe Shërbimet Mbështetëse

Qëllimi Strategjik 4: Avancimi i menaxhimit të buxhetit dhe burimeve të tjera financiare dhe shërbimeve mbështetëse në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës

Objektivi Specifik 4.1. Sigurimi i planifikimit të duhur të buxhetit të Gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të saj

Objektivi Specifik 4.2. Sigurimi i një procesi efikas dhe efektiv të zbatimit të shpenzimeve së bashku me një program të rregullt monitorimi në baza tremujore

Objektivi Specifik 4.3. Rritja e cilësisë së reagimit ndaj auditimit të jashtëm dhe mbajtja e një procesi transparent të kontrollit të brendshëm financier

Objektivi Specifik 4.4. Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes së nevojshme për Gjykatën në funksion të realizimit të objektivave të saj

Objektivi Specifik 4.5. Mirëmbajtja dhe avancimi i infrastrukturës së TI-së sipas nevojave të Gjykatës dhe në përputhje me zhvillimet në rritje të TIK-ut

Objektivi Specifik 4.1. Sigurimi i planifikimit të duhur të buxhetit të Gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të saj

Gjykata Kushtetuese tashmë ka krijuar një praktikë të duhur të planifikimit të buxhetit, e cila është në linjë me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Kjo përfshin edhe përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve si dhe përgatitjen e projekt buxhetit për çdo vit fiskal. Gjykata Kushtetuese, si një institucion me pavarësi të garantuar me Kushtetutë, ka arritur të ruaj kuotat adekuate të buxhetit të cilat kanë qenë në linjë me vetë kërkesat dhe nevojat e Gjykatës. Planifikimi i duhur buxhetor dhe në funksion të arritjes së objektivave të GJKK-së është objektiv që synohet të arrihet nga Gjykata edhe në periudhën e ardhshme gjatë zbatimit të Strategjisë. Një proces i mirëfilltë i planifikimit të brendshëm synohet të arrihet përmes themelimit të grupeve të brendshme punuese dhe vlerësimit të nevojave buxhetore të Gjykatës. Ky planifikim do të adresohet përmes KASH-it dhe planifikimit vjetor të buxhetit. Gjithë procesi i planifikimit të KASH-it dhe buxhetit vjetor do të adresohet përmes komunikimit me të gjitha strukturat e Gjykatës dhe në përputhje me afatet e përcaktuara kohore me legjislacionin në fuqi dhe qarkoret e Ministrisë së Financave. Krahas komunikimit të brendshëm, GJKK do të komunikojë në vazhdimësi dhe do të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse shtetërore në procesin e planifikimit të buxhetit. Pjesa kryesore e financimit të punës së GJKK-së pritet të mbulohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Megjithatë, Gjykata do të bashkëpunojë edhe me donatorët me qëllim të planifikimit të financimit/ bashkëfinancimit të aktiviteteve të cilat mund të financohen nga donatorët dhe që janë me interes për GJKK-në.

Objektivi Specifik 4.2. Sigurimi i një procesi efikas dhe efektiv të zbatimit të shpenzimeve së bashku me një program të rregullt monitorimi në baza tremujore

Gjykata do të vazhdojë të zbatojë dhe të avancojë proceset e saj të brendshme planifikuese që ndërlidhen me shpenzimin e buxhetit, duke përfshirë edhe monitorimin e rregullt në baza ditore të shpenzimeve. Gjykata do të përdorë sistemet e TI-së në kontabilitet për të mundësuar planifikim, shpenzim dhe raportim adekuat të shpenzimeve në përputhje me rregullat e kontabilitetit në fuqi. Me qëllim të sigurimit të një procesi efikas të planifikimit dhe të realizimit të shpenzimeve, Gjykata do të përgatisë planin vjetor të rrjedhës së parasë. Përgatitja e raporteve të rregullta tremujore dhe barazimi i shpenzimeve me sistemin SIMFK

të Thesarit do të shërbejë si një mënyrë e rregullt e monitorimit të shpenzimeve të Gjykatës. Për të siguruar që gjithë proceset e planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve janë në përputhje me planifikimet buxhetore dhe rregullat në fuqi për shpenzimin e parasë publike, Gjykata do të bëjë vlerësimë të menaxhimit të riskut, dhe raporte vetëvlerësuese të kontrollit të brendshëm.

Objktivi Specifik 4.3. Rritja e cilësisë së reagimit ndaj auditimit të jashtëm dhe mbajtja e një procesi transparent të kontrollit të brendshëm financiar

Në kuadër të këtij objktivi do të ndërmerren veprime për të rritur transparencën, kontrollin e brendshëm dhe llogaridhjen, duke u fokusuar në aktivitetet e rregullta që ndërlidhen me auditimin e brendshëm dhe raportimet. Sa i përket auditimeve të brendshme, Gjykata do të përgatisë planet e auditimit, duke përfshirë planet strategjike, vjetore, dhe tremujore. Sigurimi i transparencës synohet të realizohet dhe mbahet përmes reagimit në kohë dhe në mënyrë adekuat ndaj rezultateve të auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Për të arritur këtë, do të vendoset një mekanizëm përcjellës mbi rekandimet që dalin nga auditimet e brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë përpilimin e Planit të Veprimit për implementimin e Rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe të Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Kjo do të përfshijë monitorim të rregullt të zbatimit të rekandimeve.

Objktivi Specifik 4.4. Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes së nevojshme për Gjykatën në funksion të realizimit të objektivave të saj

Gjykata Kushtetuese ka arritur që gjatë periudhës së zbatimit të Planit Strategjik 2018-2020 të zgjidhë çështjen e rregullimit të infrastrukturës primare, që ka përfshirë zgjerimin e hapësirave të Gjykatës në përputhje me nevojat e saj. Gjatë periudhës së ardhshme planifikohet krijimi i hapësirës së nevojshme për gjykatoren në kuadër të GJKK-së. Kjo do të mundësojë që gjatë periudhës së ardhshme personeli i Gjykatës të ketë kushte optimale për të realizuar objektivat e përcaktuara me këtë strategji. Sidoqoftë, ofrimi i shërbimeve mbështetëse për Gjykatën dhe personelin e saj sipas planifikimit adekuat mbetet prioritet dhe objektiv i vazhdueshëm i Gjykatës. Në këtë funksion, është me rëndësi të adresohen në kohë dhe në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi nevojat e personelit dhe vetë Gjykata duke përfshirë identifikimin në kohë të nevojave përfurnizim me mallra dhe shërbime, planifikimi i prokurimeve dhe realizimin e prokurimit në kohë dhe në përputhje me procedurat ligjore në fuqi, sipas planit të prokurimit të përgatitur nga Gjykata. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse adekuat dhe në kohë ka efekt të drejtpërdrejtë edhe në realizimin e qëllimeve të tjera strategjike të Gjykatës.

Objktivi Specifik 4.5. Mirëmbajtja dhe avancimi i infrastrukturës së TI-së sipas nevojave të Gjykatës dhe në përputhje me zhvillimet në rritje të TIK-ut

Gjykata Kushtetuese synon që të avancojë më tej sistemet e TI-së, të cilat dojenë në funksion të realizimit të mandatit të saj. Në kuadër të këtij objktivi do të planifikohen aktivitete që avancojnë më tej punën e njësive të Gjykatës. Kjo përfshin avancimin e vazhdueshëm të sistemeve të brendshme, përmirësimin e infrastrukturës së TI-së, dhe rritjen e nivelit të sigurisë, që mundëson qasje të sigurte në burimet e të dhënave të Gjykatës.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi Strategjik 4: Avancimi i menaxhimit të buxhetit dhe burimeve të tjera financiare dhe shërbimeve mbështetëse në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës			
Objektiivi specifik 4.1. Sigurimi i planifikimit të duhur të buxhetit të Gjykatës në funksioni të realizimit të objektivave të saj			
Treguesit	Vlera bazë (baseline)	Caku 2023	Caku 2025
1. Mbajtja e kuotës aktuale të buxhetit për vitet e ardhshme;	07%	07%	07%
2. Numri i projekteve të mbështetura nga donatorët.	6	8	8
Objektiivi Specifik: 4.2. Sigurimi i një procesi efikas dhe efektiv të zbatimit të shpenzimeve së bashku me një program të rregullt monitorimi në baza tremujore			
1. Përqindja e realizimit të buxhetit vjetor, 20- 25% në çdo tremujor;	24%	25%	25%
2. Numri i raporteve financiare të dorëzuara brenda vitit fiskal;	4	4	4
3. Realizimi i të gjitha pagesave brenda afatit ligjor (numri i ditëve).	7	5	5
Objektiivi Specifik: 4.3. Rritja e cilësisë së reagimit ndaj auditimit të jashtëm dhe mbajtja e një procesi transparent të kontrollit të brendshëm financiar			
1. Implementimi i Rekomandimeve të dala nga ZKA dhe AB;	100%	100%	100%
2. Raporti i Auditorit ZKA me Opinion sipas ISSAI 200 standardeve.	0	0	0
Objektiivi specifik 4.4. Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes së nevojshme për Gjykatën në funksion të realizimit të objektivave të saj			
1. Përqindja e realizmit të Planit të Prokurimit;			
2. Shkalla e implementimit të projekteve kapitaleve;	100%	100%	100%
3. Shkalla e implementimit të rekomandimeve të dala nga AQP dhe KRPP.	100%	100%	100%
Objektiivi specifik 4.5. Mirëmbajtja dhe avancimi i infrastrukturës së TI-së sipas nevojave të Gjykatës dhe në përputhje me zhvillimet në rritje të TIK-ut			
1. Avancimi i sistemeve elektronike;	mesatar	avancuar	avancuar
2. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese;	mirë	avancuar	avancuar
3. Ngritja e sigurisë së të dhënavë nga sulmet e mundshme.	mesatar	mirë	avancuar

6.5 Komunikimi me publikun/mediat dhe Marrëdhëniet me jashtë

Qëllimi Strategjik 5: Avancimi i komunikimit me publikun/mediat dhe marrëdhënieve me jashtë

Objektivi Specifik 5.1. Përmirësimi i komunikimit brenda Gjykatës

Objektivi Specifik 5.2. Informim më i mirë i opinionit publik për punën dhe aktivitetet e Gjykatës

Objektivi Specifik 5.3. Komunikim më i mirë me mediat dhe shoqërinë civile

Objektivi Specifik 5.4. Rritja e bashkëpunimit me gjykatat e rregullta dhe komunitetin juridik

Objektivi Specifik 5.5. Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Gjykatës

Objektivi specifik 5.1. Përmirësimi i komunikimit brenda Gjykatës

Komunikimi në kohë dhe transparent brenda Gjykatës është esencial edhe për përmirësimin e komunikimit të Gjykatës me publikun/palët dhe mediat. Për përmirësimin e mëtutjeshëm të kualitetit të komunikimit të brendshëm, Gjykata do të angazhohet në finalizimin e Rregullores për komunikim të brendshëm.

Një rol me rëndësi në përmirësimin e mëtutjeshëm të komunikimit të brendshëm të Gjykatës luan edhe Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI). Për ngritjen e kapaciteteve të mëtutjeshme të ZKI-së është parashikuar angazhim i një Zyrtari/e për monitorimin e mediave dhe publikime, si dhe pjesëmarrja në trajnime të përbashkëta me zyrtarë homologë të gjykatave kushtetuese rajonale dhe evropiane.

Bashkëpunimi me zëdhënësit apo zyrtarët për komunikim me publikun nga institucionet përgjegjëse për gjyqësinë kushtetuese të vendet e rajonit dhe atyre evropiane, do të jetë në shërbim të shkëmbimit të përvojave me to dhe përritjen e kapaciteteve të Gjykatës në këtë fushë.

Objektivi Specifik 5.2. Informim më i mirë i opinionit publik për punën dhe aktivitetet e Gjykatës

Rëndësia e komunikimit me publikun për punën e Gjykatës është shumëdimensionale. Komunikimi me publikun kërkon një qasje strategjike dhe duhet të përqendrohet në:

- Informim të vazhdueshëm të publikut, jo vetëm për procedurat e zhvilluara, por edhe për aktivitetet e Gjykatës në tërësi.
- Përdorimin e të gjitha mjeteve të komunikimit në dispozicion, përfshirë teknologjitet e reja informative dhe mjetet tjera përkatëse.
- Përcaktimin e audiencës së synuar për secilin lloj të komunikimit (publik i gjërë, grupe të caktuara profesionale etj.).
- Identifikimin e situatave në të cilat secili grup i synuar ka nevojë të marrë informacion.
- Definimin e mesazhit që gjykata dëshiron të përcjellë tek publiku apo grupi i synuar.

Aktivitetet dhe qasja në avancimin e komunikimit me publikut dhe mediat do të bëhet edhe duke konsultuar udhëzuesin e Komisionit Evropian për Komunikim me Mediat dhe Publikun (CEPEJ).¹⁹

¹⁹ European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Guide on Communication with the Media and the Public for Courts and Prosecution Authorities, adopted at the 31st plenary meeting of the CEPEJ Strasbourg, më 3 dhe 4 dhjetor 2018. Gjendet në Adresën https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-ëith-media/16809025fe#_Toc5246902

Informimi më i mirë i opinionit publik përkitazi me vendimet e Gjykatës, ndër të tjera, do të bëhet edhe përmes zhvillimit të mostrave më të shkurtra të njoftimeve për media, me pikat kyçë të aktgjykimit/aktvendimit të Gjykatës në rastet e profilit të lartë (rëndësisë së veçantë).

Disa nga mjetet e komunikimit sipas udhëzuesit të CEPEJ për komunikim me mediat dhe publikun:

- Njoftime për shtyp
- Konferanca për shtyp
- Intervista
- Përgjigjet me shkrim për pyetjet me shkrim
- Uebfaqe
- Mediat sociale
- Konferanca dhe debate

Zgjerimi i mundësive për përdorim të mjeteve të ndryshme të komunikimit do të mundësojë jo vetëm komunikim të dyanshëm me publikun dhe palët e interesit, por edhe marrjen e feedback-ut i cili do të jetë i dobishëm për t'u kuptuar sa më mirë mesazhet e Gjykatës dhe për të ndikuar në zhvillimin e mëtejmë dhe përmirësimin e punës së saj. Hapja e këndit të ankesave për qytetarët nga ana e Gjykatës është një mjet shtesë që e ofron këtë mundësi.

Rritja e besueshmërisë së qytetarëve për punën e Gjykatës është e një rëndësie të madhe për këtë institucion. Rëndësia e besimit në gjyqësor është përmendur shprehimisht në një numër gjykimesh të GJEDNJ-së. GJEDNJ në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit në shoqëri, i cili, si garantues i drejtësisë, një vlerë themelore në një shtet të qeverisur nga ligji, për të qenë i suksesshëm në kryerjen e detyrave të tij duhet të gëzojë besimin e publikut.²⁰ Ndërtimi i një sistemi për këtë qëllim është edhe një nga qëllimet e kësaj strategjie. Matja e besueshmërisë së publikut për punën e Gjykatës mund të bëhet në baza të rregullta ose varësisht se kur dhe si e konsideron gjykata të nevojshme. Mundësia e organizimit të sondazheve për besueshmërinë e qytetarëve për punën e Gjykatës, do të bëhet sipas një metodologjie që do ta vendosë vetë Gjykata, si dhe me ndihmën e organizatave të specializuara në këtë lëmi.

Objktivi Specifik 5.3. Komunikim më i mirë me mediat dhe shoqërinë civile

Me gjithë aktivitetet e ndërmarra gjatë viteve të kaluara, komunikimi me jashtë i Gjykatës ende përballet me sfida bazuar në analizën SWOT. Si hap i parë që Gjykata do të ndërmarrë është rregullimi i rolit dhe përgjegjësive të brendshme, por edhe qasjes që Gjykata do të ndjek me publikun dhe mediat. Kjo mundëson që komunikimi me mediat dhe veçanërisht me shoqërinë civile të jetë sa më profesional, dhe në anën tjetër do të ndikojë që edhe shkrimet e mediave dhe qasja e tyre për informim të publikut të jetë sa më e saktë dhe profesionale. Përveç kësaj kërkohet mbajtja e konferencave për media menjëherë pas marrjes së vendimeve në rastet e profilit të lartë (rëndësisë së veçantë) ose të nesërmen (me Gjyqtarin raportues dhe Kryetarin e Gjykatës).

Mbajtja më e shpeshtë e konferencave për shtyp dhe organizimi i debateve me grupe profesionale, do të kontribuojë dukshëm në këtë aspekt. Prandaj, qasja në komunikim gjatë periudhës së ardhme do të jetë e tillë që të plotësojë nevojat e institucioneve dhe nga ana tjetër të përbashkët nga mediat dhe shoqëria civile në përgjithësi. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit me mediat, sidomos përmes një qasje të strukturuar dhe aktive të komunikimit me ta, përmes tryezave të përbashkëta ndërmjet Gjykatës dhe përfaqësuesve të mediave, si dhe mbajtjes së Konferencave Vjetore me gazetarë.

²⁰ Baka kundër Hungarisë [GC], nr. 20261/12, § 164, , 23 qershori 2016.Në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Seminari Gjyqësor 2019, Fuqizimi i besimit në gjyqësor fq. 4).

Komunikimi më i mirë i Gjykatës me shoqërinë civile është po aq i rëndësishëm për punën e saj, dhe për këtë është parashikuar organizimi i tryezave dhe diskutimeve profesionale edhe me përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe profesionistë të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut.

Objktivi specifik 5.4. Rritja e bashkëpunimit me gjykatat e rregullta dhe komuniteti juridik

Është shumë me rëndësi rritja e bashkëpunimit me palët e interesit të cilat vijnë nga sistemi i drejtësisë, komuniteti juridik, institucionet e administratës publike, etj.

Gjykata do të bashkëpunojë me Gjykatën Supreme, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatat Themelore dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës, Avokatin e Popullit, si në shpërndarjen e materialeve informative ashtu edhe në organizimin e punëtorive, takimeve, dhe organizimeve të tjera për ndarjen e informatave, shkëmbimin e përvojave dhe vendosjen e mundësive të bashkëpunimit në çështje të interesit të përbashkët.

Me qëllim të rritjes të cilësisë së punës, Gjykata do të bashkëpunojë edhe me institute të ndryshme të specializuara në zhvillimin e hulumtimeve studimore për tema të caktuara, të cilat do t'i shërbejnë Gjykatës për të përmirësuar kualitetin e vendimeve të saj.

Bashkëpunimi ka për qëllim, mes tjerash, forcimin e kapaciteteve të Gjykatës, përmirësimin e informimit, rritjen e transparencës, shkëmbimin e informatave, rritjen e cilësisë së studimeve dhe kërkimeve, si dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës së saj.

Objktivi specifik 5.5. Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Gjykatës

Aktivitetet që kanë mundësuar rritjen e bashkëpunimit të Gjykatës me akterët ndërkombëtarë, bilateral dhe multilateral, kanë qenë të shumta gjatë viteve të kaluar. Janë bërë aktivitete lobuese dhe hapa drejt anëtarësimit në Konferencën Evropiane të Gjykatave Kushtetuese (CECC) dhe Gjykata tashmë ka marrë ftesën për të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit/mysafirit në Kongresin e 18-të të Konferencës Evropiane të Gjykatave Kushtetuese. Gjatë periudhës së ardhme planifikuese, synohet anëtarësimi i Gjykatës në CECC dhe në Asociacionin Frankofon të Gjykatave Kushtetuese (ACCF).

